



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror*  
*Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice*  
*State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders*

---

**Përmbledhje e dokumentacionit bazik në përcaktimin e territorit të**

**Republikës së Kosovës**

Prishtinë

2015-2016

## Përmbajtja

1. Hyrje-Shpjegim i shkurtër i punës së Komisionit.....	4
2. Raporti për Qeverinë e Kosovës i nënshkruar nga anëtarët e komisionit 06.08.2015.....	
3. Prezentimi i Raportit të punës së Komisionit në mbledhjen e 44-të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 12 gusht 2015.....	13
4. Marrëveshja tekniko ushtarake dhe harta, Kumanovë më 10 Qershor 1999.....	15
5. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit, kapitulli VII Kosovë, faqe 117 dhe 126.....	21
6. Propozimi gjithëpërfshirës 2007, plani i Ahtisaarit faqe 1 dhe 48.....	23
7. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, 17 Shkurt 2008.....	26
8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, faqe 1 deri 4.....	29
9. Rezoluta e Kuvendit të Kosovës, 25 Qershor 2015.....	34
10. Konkluzionet e Komunës së Pejës, 13 Mars 2015.....	36
11. Dekreti nga Ligja Kushtetuese e KSAK-së 1973 dhe ligji i matjeve kadastrale të tokave 1980.....	38
12. Rregullorja e UNMIK-ut, 2000/43.....	43
13. Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal, Nr. 03L-041, 2008.....	47
14. Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe harta e KFOR-it 2012.....	79
15. Nënshkrimi i marrëveshjes së demarkacionit në Vjenë, 25 Gusht 2015.....	84
16. Deklarata e Presidentit Obama për demarkacionin Kosovë – Mali i Zi, 18 Shator 2015.....	85
17. Vlerësimi i Departamentit Amerikan për demarkacionin Kosovë – Mali i Zi, 21 Dhjetor 2015.....	87
18. Vlerësimi i Komisionit Ad-Hoc të emëruar nga Presidenca për demarkacionin Kosovë – Mali i Zi, 30 Mars 2016.....	89

# Dokumentacioni bazik që përcakton territorin e Republikës së Kosovës

**Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

**Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal, Nr. 03L-041, 2008**

**Plani – Ahtisaari, 2007**

**Marrëveshja tekniko ushtarake dhe harta, Kumanovë më 10 Qershor 1999**

**Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, 17 Shkurt 2008**

**Rezoluta e Kuvendit të Kosovës, 25 Qershor 2015**

**Dekret nga Ligja Kushtetuese e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1973**

**Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe harta e KFOR-it 2012**

**Ligji i matjeve kadastrale të tokave, 1980**

**Konkluzionet e Komunës së Pejës, 13 Mars 2015**


**Rezoluta e Këshillit të Sigurimit, kapitulli VII Kosovë**

**Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1974**

**Rregullorja e UNMIK-ut, 2000/43**

**Kushtetuta e RSFJ-së, 1974**

**Komisioni Badinter, 1991-93**





**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*  
**Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror**  
*Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice*  
**State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders**

## Hyrje

### Shpjegim i shkurtër mbi punën e komisionit

Qeveria e Republikës së Kosovës, në zbatim të detyrimeve kushtetuese për përcaktimin dhe shënjimin e kufirit shtetëror, në vitin 2012 ka ndërmarrë nismën për përcaktimin e kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Me vendimin e Qeverisë nr.12/67 të datës 21.03.2012 është themeluar Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, në përbërje të të cilit janë ekspertë nga fusha të ndryshme, përkatësisht: z. Murat Meha (Prof. Dr. i Gjeodezisë), z. Sylë Ukshini (Doktor i shkencave të Historisë), z. Tefik Basha (Prof. Dr. i Gjeografisë), z. Besim Kajtazi (Magjistër i shkencave juridike) dhe z. Shaban Guda (Kolonel i policisë së Kosovës).

Për shënjimin dhe mirëmbajtjen e vijës së kufirit, Komisioni është bazuar në parimet botërisht të pranuar (Legaliteti, Regjistrimi dhe Uti posedditi) dhe detyrimet që lindin në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Deklaratës për Shpalljen e Pavarësisë. Puna konkrete e tij është orientuar prej dokumenteve në vijim: Propozimi gjithëpërfshirës i Marti Ahtisarit për përcaktimin e statusit të Kosovës, Marrëveshjes së Kumanovës të datës 10 Qershor 1999, konkluzave të Komisionit Badinter për ish RSFJ 1991/93 dhe Kushtetutës së RSFJ-së 1974, që ishte në fuqi më 31 Dhjetor 1988.

Rezultatet e punës së komisionit janë në përputhje me kërkesat e Rezolutës së Parlamentit të Kosovës të Qershorit 2015 dhe Konkluzionet e Asamblesë Komunale të Pejës në Mars 2015.

Për përcaktimin e vijës kufitare komisioni ka grumbulluar dhe shfrytëzuar dokumentacion ekzitues ligjor, hartografik dhe teknik. Grumbullimi i këtyre informacioneve është bërë duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet qendrore (Arkiva e Kosovës, Instituti i Historisë dhe Ministrinë e tjera relevante) dhe institucionet lokale (komunat Junik, Deçan, Pejë dhe Istog). Komisioni, gjithashtu, ka grumbulluar informacione nga takimet e hapura me qytetarët e zonave përgjatë kufirit dhe me grupet tjera të interesit si Gjeodetë, Gjeografë, Ambientalistë etj.

Për Republikën e Kosovës, dokumentacioni i sipërpërmendur përfshin komunat: Junik, Deçan, Pejë dhe Istog, me zonat kadastrale përgjatë brezit kufitar Republikë e Kosovës – Mal i Zi. Këto zona kadastrale janë: 1. Junik, 2. Irzniq II, 3. Isniq, 4. Drelaj, 5. Kuqishtë, 6. Haxhaj, 7. Joshanicë, 8. Bogë, 9. Shkrel, 10. Koshutan, 11. Pepiq, 12. Reka e allagës, 13. Shtupel i vogël, 14. Lipë, 15. Novosellë, 16. Jabllanicë e madhe, 17. Jabllanicë e vogël, 18. Kaliçan.

Ndërsa, për Malin e Zi dokumentacioni përfshin komunat: Plavë, Berane dhe Rozhajë, me zonat kadastrale: 1. Prnjavor; 2. Donji Metaj; 3. Velika; 4. Shekular; 5. Kaludra; 6. Koleno; 7. Daciq; 8. Balotiq; 9. Besnik; dhe 10. Jabllanica.

Zonat kadastrale të komunave të Kosovës janë përcaktuar me Rregulloren e UNMIK nr.2000/43 (UNMIK/reg/2000/43). Kjo rregullore përcakton territorin e çdo komune, duke listuar zonat kadastrale që i përkasin secilës prej tyre.

Për shënjimin e kufirit është trajtuar dokumentacioni kadastral, në të cilin gjendet informacioni për kufijtë e zonave kadastrale, kufijtë komunal, si dhe harta të ndryshme topografike. Ky dokumentacion dhe hartat e ndryshme janë prodhuar dhe botuar nga institucione shtetërore të RSFJ-së në periudha të ndryshme kohore.

Dokumentacioni kadastral i trajtuar nga komisioni ka qenë dhe është në administrim dhe mirëmbajtje të komunave Junik, Deçan, Pejë dhe Istog. Ky dokumentacion është i plotë dhe i ruajtur që nga krijimi i tij deri më sot. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni ndër vite rezulton se, kufijtë administrativw nuk kanë pësuar asnjë ndryshim ndër vite.

Hartat topografike janë analizuar nga komisioni, duke kërkuar dokumente mbështetëse për të vërtetuar vijën teknike të ashtuquajtur vija e qarkut apo rrethit në hartat: Peja 3 në përpjesë 1:50 000 e vitit 1951 e punuar nga IGJU; Peja në përpjesë 1: 100 000 e vitit 1949 e punuar nga IGJU; dhe harta pedologjike e institutit "Jaroslav Cerni" në përpjesë 1: 50 000 e vitit 1974. Për këto vija në harta topografike nuk është gjetur ndonjë dokumentacion me bazë ligjore me të cilin vërtetohet një kufi i ndryshëm nga ai që ka përcaktuar komisioni.

Janë hulumtuar dhe analizuar gjithashtu edhe harta dhe materiale nga Enciklopeditë Jugosllave dhe Ushtarake (të radhitura sipas alfabetit), të botuara nga viti 1959 deri në vitin 1990. Hartat, në këto enciklopedi, si për Kosovën, Malin e Zi apo Serbinë janë të shkallëve të zvogëlimit 1:500 000 deri në 1: 900 000. Për shkak të pasaktësisë dhe paqartësisë së informacionit në këto harta, komisioni nuk i ka konsideruar ato si informacion me vlerë të mjaftueshme teknike dhe profesionale për përcaktimin e kufirit.

Komisioni, duke u bazuar në mandatin e deleguar nga Qeveria dhe pas përfundimit të analizës së hollësishme të dokumentacionit të sipërpërmendur, ka paraqitur propozimin për shënjimin e vijës kufitare mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Në vazhdim të këtij materiali gjenden dhe shpjegohen në mënyrë të detajuar të gjitha dokumentet e sipërpërmendura, të cilat janë trajtuar nga komisioni për përcaktimin dhe shënjimin e kufirit shtetëror ndrmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Librat, dokumentet dhe hartat e cekura në këtë tekst





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**

*Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror*  
*Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice*  
*State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders*

---

**Datë:** 06 gusht 2015

Nr. 49/2015

**Për:** Qeverinë e Republikës së Kosovës

**Nga:** Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror

**Subjekti:** Raport nga puna e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror - Vija kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Në pajtim me nenin 40 të Ligjit për kontrollin e kufirit shtetëror, Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 12/67, të datës 21.03.2012, ka themeluar Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, ndërsa me Vendimin nr. 05/28 të datës 08.05.2015 i ka vazhduar Komisionit mandatin 3 (tre) vjeçar.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e 140-të me Vendimin nr. 03/140 me datë 17.07.2013, ka miratuar Rregulloren QRK - nr. 17/2013 për Punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror (me tutje Komisioni).

Procesi i Shënimit të kufirit të Republikës së Kosovës është përshkruar në dokumentin e quajtur: Pakoja e Ahtisari 2007, Aneksi VIII, Sektori i Sigurisë në Kosovë, Neni 3 alineja 2. Kufiri i KSAK 31 Dhjetor 1988. Kjo vijë kufitare sipas Pakos të Ahtisarit është aprovuar edhe me deklaratën e shpalljes se pavarësisë të Republikës së Kosovës, me 17. Shkurt 2008. Gjithashtu kjo vijë është në përputhje të plotë me të dhënat nga viti 1974, (Kushtetuta e RSF Jugosllavisë 1974), e deri me tani.

Në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012 janë vu kontaktet protokolare me Komisionin për demarkacion dhe përcaktimin e kufirit shtetëror, caktimin e kalimeve kufitare, përcaktimin e regjimit të trafikut ndërkufitar me shtetet fqinje dhe zbatimin e strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit të Malit të Zi. Në fund të vitit 2012 është mbajtur takimi i parë për koordinimin e hapave rreth punës së dy komisioneve shtetërore, dhe me pas në muajin janar dhe shkurt 2013 janë shkëmbyer draft dokumentet që më pas janë miratuar në takimin e dytë të mbajtur më 25 dhe 26 mars 2013, ku janë shqyrtuar dhe miratuar dokumentet në vijim: *Rregulloren për punën e përbashkët të Komisionit shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës dhe Komisionit për demarkacion dhe përcaktimin e kufirit shtetëror, caktimin e kalimeve kufitare, përcaktimin e regjimit të trafikut ndërkufitar me shtetet fqinje dhe zbatimin e strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit të Malit të Zi dhe Udhëzuesin mbi punën e përbashkët të*

*komisionit për identifikimin - përcaktimin e drejtimin e shtrirjes së linjës kufitare dhe finalizimin e dokumenteve kufitare.*

Vija kufitare ndërmjet Republikës të Kosovës dhe Malit të Zi, fillon nga tre kufiri Kosovë-Shqipëri-Mal i Zi deri në pikën tre kufi Kosovë-Mal i Zi-Serbi me gjatësinë prej 78 km. Shtrirja e vijës kufitare në mes të këtyre dy shteteve është vetëm në territor mafor, duke i përshkuar pikat e larta në majat e maleve deri në 2366m lartësi mbidetare. Ndërsa pika me e ulët në vijën kufitare ndërmjet të Kosovës dhe Malit të Zi është rreth 1200m lartësi mbidetare. Komunitat Junik, Deçan, Pejë dhe Istog i kanë zonat disa zona kadastrale që njëkohësisht e përcaktojnë vijën kufitare ndërmjet me komunitat fqinje në Mal të Zi.

Komisioni ka hulumtuar, mbledhur, shqyrtuar dhe analizuar gjithë gjeoinformacionin, hartat dhe dokumentacionin për vijën kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Pastaj janë ngritur debate me ekspert, me zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, me kryetar komunash dhe me qytetarë të brezit kufitar. Për më shumë së tri vite komisioni ka gjurmuar dokumentacion por edhe ka kërkuar nga institucionet dhe nga secili qytetar që ka ndonjë dokumentacion lidhur me vijën kufitare t'ia ofrojë.

Baza e të dhënave zyrtare për Kosovën nga viti 1974 dhe të dhënat tjera në kontinuitet deri me sot 6 gusht 2015 janë identike dhe në zbatim nga organet zyrtare të Republikës së Kosovës.

Fillimisht institucioni kryesor për të dhëna kadastrale dhe kufij të Kosovës ishte "Geodetska Uprava SAPK-Pristina" e me vonë kjo drejtori u shkrua në gjuhën shqipe "Drejtoria Gjeodezike e KSAK-Prishtinë". Drejtoria Gjeodezike e KSAK-Prishtinë ishte institucion me përgjegjësi të plotë sipas "ligjit për matje dhe kadastrë të tokave", tani ngjashëm me Agjencinë Kadastrale të Kosovës në Republikën e Kosovës.

Gjeoinformacioni dhe hartat për vijën kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi janë nga baza e të dhënave të institucioneve të Kosovës: në Zyrën kadastrale - Pejë, në zyrën për pronë-Pejë, në zyrën e Agjencisë të pyjeve dega në Pejë dhe në Zyrat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Për këtë bazë të dhënave janë të informuar të gjithë qytetarët e interesuar për vijën kufitare, të cilat personalisht i kanë vizituar dhe i kanë vërtetuar në zyrat e cekura lartë, të Komunës së Pejës (në këtë rast edhe komuna e Pejës me 70 zona kadastrale është gjithnjë me sipërfaqe të njëjtë 602.2km<sup>2</sup>). Në atë territor janë bërë trashëgimi të pronave pikërisht deri në vijën kufitare me Malin e Zi.

Komisioni i Malit të Zi ka sjellë gjeoinformacion, harta dhe të dhëna kadastrale për territorin e Malit të Zi, për vijën kufitare në përputhshmëri të plotë me vijën kufitare të Republikës së Kosovës. Përputhshmëria e të dhënave nga të dy shtetet për të njëjtën vijë kufitare vazhdonë për gjithë territorin e Republikës së Kosovës me Malin e Zi. Këto dy baza të dhënave nga të dy shtetet janë në përputhshmëri për të njëjtën vijë kufitare ndërmjet dy shteteve.

Kur ceket vija kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi në periudhën 1974-2015, natyrisht, kemi parasysh që të dhënat janë dinamike, nuk krijohen brenda një viti por kufiri dhe territori administrativ(atëherë) i KSA të Kosovës dhe sot kufiri i territorit të shtetit të Republikës së Kosovës është i njëjtë dhe i pa ndryshuar.

Përputhshmëria e vijës kufitare të Republikës së Kosovës me Malin e Zi, është e bazuar në gjeoinformacionin zyrtar të Drejtorisë Gjeodeze Krahinore në Prishtinë sipas ligjit "Ligjia mbi matjen e Kadastrës e Tokëve" i nënshkruar me datë 13 Prill 1973 nga Kryetari i Kuvendit të KSAK Ilijaz Kurteshi, Fletorja Zyrtare e KSAK. Pastaj me 28 mars 1980 aprovohet "Ligji



i Matjes dhe Kadastrri i Tokave” i shpallur në Gazeta zyrtare e KSAK e vitit 1980. Në të dy ligjet është shkruar qartë se: KSA e Kosovës përgatit programet afatmesme ndërsa ato vjetore dhe mbikëqyrjen e realizon Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë në Prishtinë. Gjeoinformacioni dhe hartat e krijuar në vitin 1973, 1974-1980 dhe sot në vitin 2015 janë me kufij të njëjtë pa asnjë ndryshim që paraqitet sot.

Organizimi i atëhershëm dhe kompetencat lidhur me përkufizimin dhe mbajtjen e shënimeve të territorit që e administron me të dhënat kufitare kadastrale dhe me kadastrat e tokave në KSA të Kosovës është i ngjashëm me kompetencat e tanishme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe të Zyrës Kadastrale të Komunave, natyrisht edhe të Pejës (krahaso ligjin për kadastër atëherë dhe sot). Këtu duhet cekur se Komuna e Pejës pas luftës ka përparësi të mëdha ndaj shumë komunave të Republikës së Kosovës, asaj nuk i mungon asnjë dokument kadastral dhe i kufijve, e ka arkivin e plotë - të pa plaçkitur nga Serbia dhe të skanuar e të Arkivuar në Zyren Kadastrale të Pejës dhe në Agjencion Kadastral të Kosovës. Kjo vërtetohet edhe me kërkesat e qytetareve të sqaruara në vijim në kapitullin 5 të këtij raporti. Prandaj, baza e të dhënave dhe gjeoinformacioni për vijën e kufirit është e pandryshuar dhe e prezantuar në vijim me gjeoinformacionin e saktë, nga komisioni në periudhën 1974-2015. Shih dokumentacionin në vijim:

- Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, para dhe pas vitit 1974;
- Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë e KSA të Kosovës para dhe pas vitit 1974;
- Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë kishte kompetenca të ngjashme me ato tani të Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
- Geodetska Uprava SAPK-Pristina, 1974;
- Geodetska Uprava NR. Serbia 1959;
- Ligji “Ligji mbi matjen e Kadastrën e Tokëve” i nënshkruar me datë 13 Prill 1973 nga Kryetari i Kuvendit të KSAK Ilijaz Kurteshi, Fletorja Zyrtare e KSAK;
- “Ligji i Matjes dhe Kadastrri i Tokave” i shpallur në Gazeta zyrtare e KSAK me 28 mars 1980;
- Kufiri i Zonave kadastrale 1974, 1988, 2015;
- Regjistrat e ndërrimeve kadastrale në komunat kufitare 1974, 2015;
- Harta e KFOR për zonën e Sigurisë të Kosovës nga Marrëveshja e Kumanovës;
- Pakoja e Ahtisarit (kufijtë administrativ të datës 31 dhjetor 1988) e deri me tani;
- Ky gjeoinformacion, harta dhe dokumentacion gjithnjë paraqet vijën e njëjtë administrative të konvertuar në kufi shtetëror të Republikës së Kosovës;
- Kjo vijë administrative/tani kufi shtetëror ka qenë dhe është zyrtar, është përditësuar dhe përditësohet që nga viti 1974 deri me sot;
- Agjencinë Kadastrale të Kosovës 2000-2015, Autoriteti më i lartë për Gjeodezi, Kadaster dhe Hartografi është bërë në shërbim të qytetarëve në Republikën e Kosovës,
- Zyrat kadastrale të komunave Junik, Deçan, Pejë dhe Istog janë në shërbim të qytetarëve, në përditësim të dhënave kadastrale e kufitare çdo ditë pune;

- Gjeoinformacioni dhe hartat e krijuara në vitin 1973, 1974 1980, 1988 dhe sot në vitin 2015 janë me vijën kufitare të njëjtë me Malin e Zi pa asnjë ndryshim;

Nga të dhënat e përshkruara me lartë kanë përfutuar shumë qytetarë të zonës që kishin prona në territor të Malit të Zi. Ata sollën dokumentacionin pastaj sipas udhëzimeve të komisionit e regjistruan pronën tyre ku e kishin edhe më herët, ndaj rastet janë mbyllur nga vetë Komunitat kufitare: Juniku, Deçani dhe Istogu (Burimi).

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror të Republikës së Kosovës (komisioni - KShShMKSh) realizoi takime në zyre, në salla të mëdha dhe në terren me kryetaret e komunave të brezit kufitar, me banorët e fshatrave të brezit kufitar. Takimi me Kryetarin e Komunës së Pejës, ish Kryetari z. Ali Berisha. Takimi me datë, 05 03 2014 në zyrën e kryetarit z. Gazmend Muhaxheri që pjesëmarrës ishte edhe përfaqësuesi i zyrës kadastrale të Pejës z. Shkëmb Kastrati-gjeodet dhe dhjetëra qytetar nga brezi kufitar. Në këtë takim komisioni - KShShMKSh prezantoi gjeoinformacionet e vijës së kufirit me Malin e Zi. Gjithashtu u sqarua jo njëherë “se vija kufitare me Malin e Zi do të shënohet sipas të dhënave kadastrale të komunave e në këtë rast edhe Komuna e Pejës i ka në shfrytëzim nga viti 1974 e cila është e njohur për Ju, e dini të gjithë”. Këtë e sqaroi edhe përfaqësuesi i zyrës kadastrale të Pejës z. Shkëmb Kastrati gjeodet i cili e ceku: “Zyra kadastrale e Komunës së Pejës edhe sot e kësaj dite azhurnimin dhe piketimin e të dhënave kadastrale e bënë në të njëjtat plane kadastrale me të njëjtën vij kufitare si në vitin 1974 ashtu edhe sot në 2014”. Pas kësaj nga komisioni - KShShMK u kërkua nga qytetarët e interesuar që ta konsultojnë Kadastrin e Pejës lidhur me pronat e tyre sepse aty i keni të gjitha shënimet zyrtare, e në rast vështirësie Komisioni iu ndihmon. Njëkohësisht të gjithë të pranishmeve iu sqarua dallimi në mes të pronësisë dhe shfrytëzuesit mbi pronën e paluajtshme. Gjithashtu informacioni për kufirin shtetëror u paraqit edhe me projektor.

Pronaret nga Kosova të cilët kishin prona në komunën: Plavë (Bjelluhë), Beranë (Vllahovi) dhe Rozhajë (Gradinë), pas këtyre takimeve me përfaqësuesit e komunave dhe me qytetarët e zonave kufitare sollën listën me 37 emra të cilët i kanë përkufizuar dhe realizuar pronat e tyre në Mal të Zi. Kjo listë është e arkivuar me adresa të sakta të pronareve dhe shtesë e këtij raporti.

Banorët e fshatrave të komunës së Pejës, Deçanit dhe Istogut me datë 06 06 2013, bëjnë kërkesë në Kuvendin e Republikës së Kosovës: “Kërkesa jonë është të na mundësohet lejimi i daljes në bjeshkë vetëm për shfrytëzimin e kullosave”, pastaj fjalia tjetër në kërkesë është “Edhe pse për këto bjeshkë ka dëshmi të shumta që banorët e këtyre fshatrave i kanë blerë dhe kanë paguar taksë për shfrytëzimin e kullosave në komunën e Rozhajës”. Kërkesës se lartcekur i ishte bashkëngjitur edhe kërkesa e tyre e më hershme e dërguar me nënshkrime të Kryetari i Komunës së Rozhajës z. Nusret Kalaq. Këto dy shkresa janë të arkivuara dhe e bashkëngjitur në këtë raport.

Komisioni, gjatë procesit të shënjimit të vijës kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, ka pas në konsideratë kujdesin maksimal ndaj pronave në zonën kufitare, duke kërkuar nga secili pretendues- pronar të bëjë kufizimin e pronës se vete në terren sipas dokumentacionit që ka. Gjithashtu Komisioni ka mbajtur dhjetëra takime me banorët e zonës kufitare, për të iu sqaruar të dhënat dhe për të shqyrtuar kërkesat e tyre. Në këtë aktivitet, pronat e qytetarëve nga komuna e Junikut, Deçanit, Pejës dhe Istogut në territorin e Malit të Zi për të cilët kishte dokumentacion janë përkufizuar atje. Tani, ato prona të përkufizuara, duke iu falënderuar bashkëpunimit të qytetarëve me komisionin, i kanë në pronësi dhe janë duke i shfrytëzuar pa asnjë pengesë.

Parimet e Komisionit Shtetëror përveç argumenteve profesionale relevante dhe saktësisë, janë Transparenca dhe Informimi për progresin e punës në shënjimin e vijës kufitare duke prezantuar dokumentacionin relevant për kufirin. Përveç raportimit të rregullt në Kryeministri, në Ministri të Punëve të Jashtme dhe Ministri të Punëve të Brendshme, janë mbajtur edhe një varg takimesh me kryetaret dhe këshilltaret e komunave të brezit kufitar, si të komunës së Junikut, Deçanit, Pejës dhe Istogut dhe takimet me banoret në terren pranë zonave kufitare. Gjithashtu janë realizuar edhe takimet trelaterale ndërmjet Republikës së Kosovës, Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë.

Komisioni për prezantim dhe sqarime të vijës kufitare ka organizuar: 16 takime bilaterale, 2 takime trelaterale, 17 takime të rregullta të komisionit vendor sipas rregullores së punës. Janë organizuar dhe mbajtur mbi 20 takime të drejtpërdrejta në terren me qytetaret e zonë, takime me kryetaret e Komunave kufitare si me: Haki Rugova-Istog, ish kryetarin e Pejës Ali Berisha, me kryetarin aktual Gazmend Muhaxheri-Pejë, Rasim Selmanaj-Deçan, Agron Kuçi-Junik. Takimet janë mbajtur në zyrat e tyre Komunale. Po ashtu, komisioni ka bërë prezantim informues në Asambleenë e Komunës së Pejës me 13 Mars 2015 para asamblistëve dhe qytetareve të komunës së Pejës, duke ofruar dokumentacionin relevant për kufirin Kosovë-Mali i Zi. Për të gjitha takimet e sipër cekura janë përgatitur materialet, janë dhënë sqarime dhe janë procesverbalet e arkivuara në Sekretarinë e Komisionit. Është bërë trajtimi i përbashkët dhe analiza e dokumentacionit të sjellë nga Agjencia e Pyjeve për territorin e brezit kufitar me Malin e Zi.

Komisioni ka bërë trajtimin e secilës pikë veç e veç në vijën kufitare, ka përshkuar në terren vijën kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi duke zbatuar parimin e transparencës.

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror dëshiron të sigurojë, Qeverinë e Republikës së Kosovës me qytetarët e saj, se është duke kryer me përkushtim, devotshmëri, me profesionalizëm të lartë dhe me përpikëri detyrat ligjore dhe teknike. Shënjimi i vijës kufitare me Malin e Zi është në përputhshmëri të plotë me linjën kufitare sipas Kushtetutës së vitit 1974, me Planin e Ahtisaarit dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Baza e të dhënave për zonat kadastrale në vijën kufitare e garanton mos ndryshimin e kufirit të Republikës së Kosovës me Malin e Zi, prandaj kushdo që interesohet për pronat e tyre apo për territorin e Republikës së Kosovës, mund të shkojë në Zyrën Kadastrale të komunës përkatëse dhe të Kryetari i Komunës, që ta vërtetojë cilin territor të komunës ai e administron dhe me cilat të dhëna për cilin territor të komunës u ka shërbyer qytetareve që nga vitit 1974 e deri me sot korrik 2015. Ndërsa për pronat që i kanë në Mal të Zi, natyrisht duhet të paraqiten atje. Politikisht duhet deklaruar vet Kryetaret e Komunave nëpërmjet zyrës kadastrale komunale deri ku e kanë territorin komunal. Të njëjtat gjeoinformacione, harta dhe dokumente me të njëjtën vijë kufitare me Malin e Zi ato komuna e kanë në dispozicion në gjithë periudhën, 1974, 1988 dhe sot 2015.

Përputhshmëria e vijës kufitare të Republikës së Kosovës me Malin e Zi, si u cek me lartë është e bazuar në gjeoinformacionin zyrtar të Drejtorisë Gjeodeze Krahinore në Prishtinë sipas ligjit “Ligja mbi matjen e Kadastrën e Tokëve” i nënshkruar me datë 13 Prill 1973 nga Kryetari i Kuvendit të KSAK Ilijaz Kurteshi, Fletorja Zyrtare e KSAK. Pastaj me 28 mars 1980 aprovohet “Ligji i Matjes dhe Kadastrë i Tokave” i shpallur në Gazeta zyrtare e KSAK. Në të dyja ligjet është shkruar qartë se : KSA e Kosovës përgatit programet afatmesme ndërsa ato vjetore dhe mbikqyrjen e realizon Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë në Prishtinë.

Gjeoinformacioni dhe hartat e krijuara në vitin 1973, 1974 1980 dhe sot në vitin 2015 janë me kufij të njëjtë me Malin e Zi pa asnjë ndryshim, kjo është konstatuar edhe për periudhën e viteve 1933/34, 1959 të përpiluara nga “Geodetska Uprava NR Serbije”.

Për ta lehtësuar edhe me shumë kuptimin e kësaj që u tha deri me tani në vazhdim janë gjeoinformacionet dhe hartat në mënyrë kronologjike duke filluar nga krijimi i sektorëve trigonometrik për gjithë RSF të Jugosllavisë në kuadër të cilës ishte edhe Kosova e deri në gjeoinformacionin dhe hartën kadastrale të azhurnuar nga kadastri i komunave kufitare (Junik, Deçan, Pejë dhe Istog), të arkivuara atje dhe në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Nuk ka forcë, as mjet që e detyrojnë Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror të punoj kundër interesave të shtetit të vet-të Republikës së Kosovës.

Komisioni e ka bërë punën hulumtuese, profesionale dhe shkencore duke vërtetuar dhe ofruar për vijën kufitare çdo gjeoinformacion të nevojshëm, prandaj është garantuar që asnjë milimetër katror i territorit të Republikës së Kosovës, me këtë vijë kufitare nuk do të tjetërsohet.

Këtij raporti i bashkëngjitet i tërë dokumentacioni i trajtuar nga Komisioni për shënimin e vijës kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, duke përfshirë gjeoinformacionin, hartat, dokumentacionin e nevojshëm dhe marrëveshjen dypalëshe me shtojcat për kufirin shtetëror.

Me respekt nga: Komisioni shtetëror:

Prof. Dr. Murat Meha,

Kryesues komisioni,

Mr.sc. Sylë Ukshini,

Anëtar komisioni,

Kolonel Shaban Guda

Anëtar komisioni,

Mr.sc Besim Kajtazi

Anëtar komisioni,

Prof. Dr. Tefik Basha,

Anëtar komisioni,





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror*  
*Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice*  
*State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders*

Datë: 12 Gusht 2015

Nr. 50/2015

Për: Qeverinë e Republikës së Kosovës

Nga: Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror

**Prezantim i raportit të punës i Komisionit në mbledhjen e 44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës**



**Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror**, i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në përbërje Prof. Dr. Murat Meha, Kryesues, AKK; Mr.sc. Sylë Ukshini, Anëtar, MPJ; Kolonel Shaban Guda Anëtar, MPB; Mr.sc Besim Kajtazi, Anëtar, ZKM; Prof. Dr. Tefik Basha, Anëtar, UP; ka realizuar detyrën sipas ligjit, Pakos së Ahtisarit, mbështetur në të dhëna zyrtare të vitit 1974-qe ishte kushtetuta e RSFJ 1974, Mendimet e Komisionit Badinter për ish Jugosllavinë 1991/93 e deri me sot.

Shënimi i vijës kufitare është proces **teknik** (puna e komisionit), **ligjor** (detyrat dhe obligimet ligjore) dhe **vendimi politik** të cilin e vendos për lënien e kufirit të pa mbyllur, e dërgon në Arbitrazh apo e aprovon ate mbi bazën e dokumentacionit zyrtar. Për këtë dhe kërkesat e qytetareve rreth kufirit duhet të u përgjigjet Qeveria e Kosovës

Komisioni kishte për detyrë të shënoj vijën administrative qe e kishte Krahinë Socialiste Autonome e Kosovës brenda RSF e Jugosllavisë ndërsa tani bëhet kufi ndërkombëtar i Republikës së Kosovës duke involvuar principin *Uti Possidetis* kur shteti është krijuar nga territori i përkufizuar qe e kishte me herët.

Ndërsa, me shënimin e vijës kufitare, në këtë rast nuk krijohen kufij të ri por shënohen kufijtë administrativ qe i kishte KSA-Kosovë duke i kthyer të njëjtit në kufij shtetëror.

Kufiri ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi është i bazuar në gjeoinformacionin, në hartat dhe në dokumentacionin zyrtar të KSA-Kosovës.

Dokumentacioni nuk ka pësuar ndryshime, çka vërtetohet me gjeoinformacionin, me hartat dhe dokumentacionin zyrtar nga:

1. Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, para dhe pas vitit 1974;

2. Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë e KSA të Kosovës para dhe pas vitit 1974 (Geodetska Uprava SAPK-Pristina, 1974). Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë kishte kompetenca të ngjashme me këto të Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
3. Drejtoria Gjeodezike e RP të Serbisë (Geodetska Uprava NR. Serbija 1959);
4. Gjeoinformacioni, hartat dhe dokumentacioni i përpiluar në bazë të Ligjit “Ligja mbi matjen e Kadastrën e Tokëve” i nënshkruar me datë 13 Prill 1973 nga Kryetari i Kuvendit të KSAK Ilijaz Kurteshi, Fletorja Zyrtare e KSAK. “Ligji i Matjes dhe Kadastrë i Tokave” i shpallur në Gazeta zyrtare e KSAK me 28 mars 1980;
5. Kufiri i Zonave kadastrale në zbatim në vitet 1974, 1988, 2015;
6. Regjistrat e ndërrimeve kadastrale në komunat kufitare 1974, 2015;
7. Harta e KFOR për zonën e Sigurisë të Kosovës nga Marrëveshja e Kumanovës;
8. Pakoja e Ahtisarit (kufijtë administrativ të datës 31 dhjetor 1988) e deri me tani;
9. Agjencia Kadastrale të Kosovës 2000-2015, Autoriteti me i lartë për Gjeodezi, Kadaster dhe Hartografi është bërë në shërbim të qytetarëve në Republikën e Kosovës,
10. Zyrat kadastrale të komunave Junik, Deçan, Pejë dhe Istog janë në shërbim të qytetarëve, në përditësim të dhënave kadastrale e kufitare çdo ditë pune;

Ky gjeoinformacion, këto harta dhe dokumentacion zyrtar i krijuara në vitin 1973, 1974, 1980, 1988 dhe sot në vitin 2015 paraqet vijën e njëjtë administrative të konvertuar në kufi shtetëror.

Baza e të dhënave për zonat kadastrale në vijën kufitare e garanton mos ndryshimin e kufirit të Republikës së Kosovës me Malin e Zi. Kushdo që interesohet për pronat e tyre apo për territorin e Republikës së Kosovës, mund të vërtetoj në Zyrën Kadastrale të komunës përkatëse.

Sipas gjithë kësaj që u tha, pas hulumtimeve profesionale e shkencore, iu raportojmë se hartat topografike, ushtarake, pedologjike, etnike, pyjore, historike nuk kanë dokumentacion tjetër teknik për sqarim në bazë të cilit do të bëhej shënimi i kufirit shtetëror. Ndërsa, në dispozicion janë gjeoinformacioni, hartat dhe dokumentacioni zyrtar i Kosovës. Mbështetur në dokumentacion, raportojmë se nuk ka shmangie as për një metër nga vija administrative, tani kufiri shtetëror i Republikës së Kosovës nga viti 1974-1988-2015.

Parimet e punës të Komisionit Shtetëror përveç argumenteve profesionale relevante dhe saktësisë, janë Transparenca dhe Informimi i rregullt i qytetarëve dhe institucioneve për progresin e punës në shënjimin e vijës kufitare.

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror ka realizuar me sukses projektin e shënimit të vijës administrative të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, tani kufiri shtetëror i Republikës së Kosovës, që duhet të njihet ndërkombëtarisht.

Qeverisë së Republikës së Kosovës i ofrohet ky raport i punës të Komisionit për shqyrtim dhe për të vazhduar procedurat tjera.

Këtij raporti i bashkëngjitet i tërë dokumentacioni i trajtuar nga Komisioni për shënjimin e vijës kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, duke përfshirë atlasin me gjeoinformacionin, hartat, dokumentacionin zyrtar dhe marrëveshjen dypalëshe për kufirin shtetëror me shtojcat.

Me respekt nga: Komisioni shtetëror.

# Marrëveshja tekniko ushtarake, Kumanovë më 10 Qershor 1999

## Military Technical Agreement (June 3 1999)

between the International Security Force ("KFOR") and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia

### Article I: General Obligations

1. The Parties to this Agreement reaffirm the document presented by President Ahtisaari to President Milosevic and approved by the Serb Parliament and the Federal Government on June 3, 1999, to include deployment in Kosovo under UN auspices of effective international civil and security presences. The Parties further note that the UN Security Council is prepared to adopt a resolution, which has been introduced, regarding these presences.

2. The State Governmental authorities of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia understand and agree that the international security force ("KFOR") will deploy following the adoption of the UNSCR referred to in paragraph 1 and operate without hindrance within Kosovo and with the authority to take all necessary action to establish and maintain a secure environment for all citizens of Kosovo and otherwise carry out its mission. They further agree to comply with all of the obligations of this Agreement and to facilitate the deployment and operation of this force.

3. For purposes of the agreement, the following expressions shall have the meanings as described below:

a. "The Parties" are those signatories to the Agreement.

b. "Authorities" means the appropriate responsible individual, agency, or organisation of the Parties.

c. "FRY Forces" includes all of the FRY and Republic of Serbia personnel and organisations with a military capability. This includes regular army and naval forces, armed civilian groups, associated paramilitary groups, air forces, national guards, border police, army reserves, military police, intelligence services, federal and Serbian Ministry of Internal Affairs local, special, riot and anti-terrorist police, and any other groups or individuals so designated by the international security force ("KFOR") commander.

d. The Air Safety Zone (ASZ) is defined as a 25-kilometre zone that extends beyond the Kosovo province border into the rest of FRY territory. It includes the airspace above that 25-kilometre zone.

e. The Ground Safety Zone (GSZ) is defined as a 5-kilometre zone that extends beyond the Kosovo province border into the rest of FRY territory. It includes the terrain within that 5-kilometre zone. **Se added mapp in scale 1: 100 000.**

**e. Zona Tokësore e Sigurisë (ZTS) është përcaktuar si një zonë 5 kilometërshe që zgjatet jashtë territorit të Kosovës, në vazhdim të territorit të RFJ-së. Kjo përfshin terrenin brenda atyre 5 kilometrave.**

the FRY and the Republic of Serbia enter into, reenter, or remain within the territory of Kosovo or the Ground Safety Zone (GSZ) and the Air Safety Zone (ASZ) described in paragraph 3. Article I without the prior express consent of the international security force ("KFOR") commander. Local police will be allowed to remain in the GSZ.

The above paragraph is without prejudice to the agreed return of FRY and Serbian personnel which will be the subject of a subsequent separate agreement as provided for in paragraph 6 of the document mentioned in

### **9 June 1999 paragraph 1 of this Article.**

a. To provide for the support and authorization of the international security force ("KFOR") and in particular to authorize the international security force ("KFOR") to take such actions as are required, including the use of necessary force, to ensure compliance with this Agreement and protection of the international security force ("KFOR"), and to contribute to a secure environment for the international civil implementation presence, and other international organisations, agencies, and non-governmental organisations (details in Appendix B).

#### Article II: Cessation of Hostilities

1. The FRY Forces shall immediately, upon entry into force (EIF) of this Agreement, refrain from committing any hostile or provocative acts of any type against any person in Kosovo and will order armed forces to cease all such activities. They shall not encourage, organise or support hostile or provocative demonstrations.

2. Phased Withdrawal of FRY Forces (ground): The FRY agrees to a phased withdrawal of all FRY Forces from Kosovo to locations in Serbia outside Kosovo. FRY Forces will mark and clear minefields, booby traps and obstacles. As they withdraw, FRY Forces will clear all lines of communication by removing all mines, demolitions, booby traps, obstacles and charges. They will also mark all sides of all minefields. International security forces' ("KFOR") entry and deployment into Kosovo will be synchronized. The phased withdrawal of FRY Forces from Kosovo will be in accordance with the sequence outlined below:

a. By EIF + 1 day, FRY Forces located in Zone 3 will have vacated, via designated routes, that Zone to demonstrate compliance (depicted on the map at Appendix A to the Agreement). Once it is verified that FRY forces have complied with this subparagraph and with paragraph 1 of this Article, NATO air strikes will be suspended. The suspension will continue provided that the obligations of this agreement are fully complied with, and provided that the UNSC adopts a resolution concerning the deployment of the international security force ("KFOR") so rapidly that a security gap can be avoided.

b. By EIF + 6 days, all FRY Forces in Kosovo will have vacated Zone 1 (depicted on the map at Appendix A to the Agreement). Establish liaison teams with the KFOR commander in Pristina.

c. By EIF + 9 days, all FRY Forces in Kosovo will have vacated Zone 2 (depicted on the map at Appendix A to the Agreement).

d. By EIF + 11 days, all FRY Forces in Kosovo will have vacated Zone 3 (depicted on the map at Appendix A to the Agreement).

e. By EIF +11 days, all FRY Forces in Kosovo will have completed their withdrawal from Kosovo (depicted on map at Appendix A to the Agreement) to locations in Serbia outside Kosovo, and not within the 5 km GSZ. At the end of the sequence (EIF + 11), the senior FRY Forces commanders responsible for the withdrawing forces shall confirm in writing to the international security force ("KFOR") commander that the FRY Forces have complied and



completed the phased withdrawal. The international security force ("KFOR") commander may approve specific requests for exceptions to the phased withdrawal. The bombing campaign will terminate on complete withdrawal of FRY Forces as provided under Article II. The international security force ("KFOR") shall retain, as necessary, authority to enforce compliance with this Agreement.

f. The authorities of the FRY and the Republic of Serbia will co-operate fully with international security force ("KFOR") in its verification of the withdrawal of forces from Kosovo and beyond the ASZ/GSZ.

g. FRY armed forces withdrawing in accordance with Appendix A, i.e. in designated assembly areas or withdrawing on designated routes, will not be subject to air attack.

h. The international security force ("KFOR") will provide appropriate control of the borders of FRY in Kosovo with Albania and FYROM (1) until the arrival of the civilian mission of the UN.

### 3. Phased Withdrawal of Yugoslavia Air and Air Defence Forces (YAADF)

a. At EIF + 1 day, no FRY aircraft, fixed wing and rotary, will fly in Kosovo airspace or over the ASZ without prior approval by the international security force ("KFOR") commander. All air defence systems, radar, surface-to-air missile and aircraft of the Parties will refrain from acquisition, target tracking or otherwise illuminating international security ("KFOR") air platforms operating in the Kosovo airspace or over the ASZ.

b. By EIF + 3 days, all aircraft, radars, surface-to-air missiles (including man-portable air defence systems (MANPADS)) and anti-aircraft artillery in Kosovo will withdraw to other locations in Serbia outside the 25 kilometre ASZ.

c. The international security force ("KFOR") commander will control and coordinate use of airspace over Kosovo and the ASZ commencing at EIF. Violation of any of the provisions above, including the international security force ("KFOR") commander's rules and procedures governing the airspace over Kosovo, as well as unauthorised flight or activation of FRY Integrated Air Defence (IADS) within the ASZ, are subject to military action by the international security force ("KFOR"), including the use of necessary force. The international security force ("KFOR") commander may delegate control of normal civilian air activities to appropriate FRY institutions to monitor operations, deconflict international security force ("KFOR") air traffic movements, and ensure smooth and safe operations of the air traffic system. It is envisioned that control of civil air traffic will be returned to civilian authorities as soon as practicable.

### Article III: Notifications

1. This agreement and written orders requiring compliance will be immediately communicated to all FRY forces.

2. By EIF +2 days, the State governmental authorities of the FRY and the Republic of Serbia shall furnish the following specific information regarding the status of all FRY Forces:

a. Detailed records, positions and descriptions of all mines, unexploded ordnance, explosive devices, demolitions, obstacles, booby traps, wire entanglement, physical or military hazards to the safe movement of any personnel in Kosovo laid by FRY Forces.

b. Any further information of a military or security nature about FRY Forces in the territory of Kosovo and the GSZ and ASZ requested by the international security force ("KFOR") commander.

#### Article IV: Establishment of a Joint Implementation Commission (JIC)

A JIC shall be established with the deployment of the international security force ("KFOR") to Kosovo as directed by the international security force ("KFOR") commander.

#### Article V: Final Authority to Interpret

The international security force ("KFOR") commander is the final authority regarding interpretation of this Agreement and the security aspects of the peace settlement it supports. His determinations are binding on all Parties and persons.

#### Article VI: Entry Into Force

This agreement shall enter into force upon signature.

#### Appendices:

##### A. Phased withdrawal of FRY Forces from Kosovo

(176Kb)

##### B. International security force ("KFOR") operations

1. Consistent with the general obligations of the Military Technical Agreement, the State Governmental authorities of the FRY and the Republic of Serbia understand and agree that the international security force ("KFOR") will deploy and operate without hindrance within Kosovo and with the authority to take all necessary action to establish and maintain a secure environment for all citizens of Kosovo.

2. The international security force ("KFOR") commander shall have the authority, without interference or permission, to do all that he judges necessary and proper, including the use of military force, to protect the international security force ("KFOR"), the international civil implementation presence, and to carry out the responsibilities inherent in this Military Technical Agreement and the Peace Settlement which it supports.

3. The international security force ("KFOR") nor any of its personnel or staff shall be liable for any damages to public or private property that they may cause in the course of duties related to the implementation of this Agreement. The parties will agree a Status of Forces Agreement (SOFA) as soon as possible.

4. The international security force ("KFOR") shall have the right:

a. To monitor and ensure compliance with this Agreement and to respond promptly to any violations and restore compliance, using military force if required.

This includes necessary actions to:

1. Enforce withdrawals of FRY forces.

2. Enforce compliance following the return of selected FRY personnel to Kosovo


3. Provide assistance to other international entities involved in the implementation or otherwise authorised by the UNSC.

b. To establish liaison arrangements with local Kosovo authorities, and with FRY/Serbian civil and military authorities.


c. To observe, monitor and inspect any and all facilities or activities in Kosovo that the international security force ("KFOR") commander believes has or may have military or police capability, or may be associated with the employment of military or police capabilities, or are otherwise relevant to compliance with this Agreement.

5. Notwithstanding any other provision of this Agreement, the Parties understand and agree that the international security force ("KFOR") commander has the right and is authorised to compel the removal, withdrawal, or relocation of specific Forces and weapons, and to order the cessation of any activities whenever the international security force ("KFOR") commander determines a potential threat to either the international security force ("KFOR") or its mission, or to another Party. Forces failing to redeploy, withdraw, relocate, or to cease threatening or potentially threatening activities following such a demand by the international security force ("KFOR") shall be subject to military action by the international security force ("KFOR"), including the use of necessary force, to ensure compliance.

### Legjenda e kufinjëve në hartën e KFOR-it nga marreveshja e 10 Qershorit 1999



**Harta topografike e KFOR-it sipas marrëveshjes së Kumanovës  
Kufiri Kosovë - Mal i Zi dhe zona e sigurisë**



## Kosovo

### 4

## Kosovo

<Débora García-Orrico>

### Synopsis

In March 1999, the North Atlantic Treaty Organisation (NATO) launched a military campaign in Kosovo without the prior endorsement of the United Nations Security Council (UNSC). The goal of the operation was to bring to an end increasing fighting between Serbian government forces and armed Kosovo-Albanian separatist groups that had a serious humanitarian impact. The Security Council had earlier been seized of the situation in Kosovo and adopted three resolutions which, among others, imposed a comprehensive arms embargo, condemned the excessive use of force by Serbian forces and acts of terrorism by Kosovo-Albanian groups, ordered the withdrawal of Serbian forces, and called for dialogue to reach a political solution to the crisis.<sup>1</sup> NATO's air campaign, starting on 24 March and concluding on 9 June, resulted in the withdrawal of Serbian forces from the territory, their replacement by international peace forces, and the massive return of the displaced Kosovo-Albanian population. In May, the G-8 foreign ministers agreed on a set of guiding principles designed to achieve a political solution to the crisis. After 78 days of bombardment and under pressure from Russia, Serbian President Slobodan Milošević accepted the ceasefire conditions and signed the Military-Technical Agreement on 9 June 1999.<sup>2</sup>

On 10 June 1999, the Security Council adopted resolution 1244 (1999),<sup>3</sup> based on the G-8 agreed principles<sup>4</sup> under Chapter VII authorising the deployment in Kosovo, under UN auspices, of an international civil presence – the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK), established by the Secretary-General with the assistance of the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR), the Organisation for Security and Cooperation in Europe (OSCE), the European Union (EU) and the UN Secretariat;<sup>5</sup> and a security presence – the Kosovo Force (KFOR),

<sup>1</sup> United Nations Security Council resolution 1239 of 14 May 1999; United Nations Security Council resolution 1203 of 24 October 1998; United Nations Security Council resolution 1199 of 23 September 1998; and United Nations Security Council resolution 1160 of 31 March 1998; amongst others. Available at [www.un.org/Docs/sc](http://www.un.org/Docs/sc).

<sup>2</sup> Military-Technical Agreement between the International Security Force and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia, signed in Kumanovo on 9 June 1999, available at [www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm](http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm).

<sup>3</sup> United Nations Security Council resolution 1244 of 10 June 1999, available at [www.un.org/Docs/scres/1999/sc99.htm](http://www.un.org/Docs/scres/1999/sc99.htm).

<sup>4</sup> Included as Annex 1 to United Nations Security Council resolution 1244, op.cit.

<sup>5</sup> United Nations Security Council resolution 1244, op. cit., paras. 5, 6 and 10.

a meeting held on 3-4 June in Belgrade, a peace deal with President Milošević was brokered by EU Special Envoy Martti Ahtisaari and Russian Federation Special Envoy Viktor Chernomyrdin, accompanied by Special Adviser Valentin Sergejev. On 5 June, representatives of NATO and of the Yugoslav government finalised the details in preparation of a Military-Technical Agreement. Finally, on 8 June, G-8 foreign ministers, at a meeting held in Cologne, reached an agreement on a draft resolution on Kosovo for the UN Security Council, and EU Special Envoy Ahtisaari met the Chinese president and the Chinese foreign minister in Beijing. After 78 days of air campaign and under Russia's pressure, Milošević accepted the ceasefire conditions and signed the Military-Technical Agreement, on 9 June 1999.<sup>25</sup>

### III. Mandate design and origin

On 10 June 1999, the Security Council adopted resolution 1244. Approved with 14 affirmative votes and one abstention (China), the resolution authorised the deployment of international security and civil presences in Kosovo under UN auspices and laid down the mandate for both operations. The table below sets out the main responsibilities assigned to KFOR and UNMIK.

Main responsibilities of international presences	
Security (KFOR) <sup>26</sup>	Civil (UNMIK) <sup>27</sup>
<p>To maintain and enforce the cease-fire;</p> <p>To ensure the withdrawal and to prevent the return of Serbian forces, except of those allowed to return to liaise with the international presences, to mark/clear minefields and to maintain a presence at patrimonial sites and key border crossings;</p> <p>To demilitarise the Kosovo Liberation Army and other armed Kosovo-Albanian groups;<sup>28</sup></p> <p>To establish a secure environment for those displaced to return in safety, for humanitarian aid to be delivered and for the international civil presence to operate;</p> <p>To conduct border monitoring duties;</p> <p>To ensure the protection and freedom of movement of international organisations;</p> <p>To ensure public safety and order and supervise demining until the international civil presence takes over those responsibilities.</p>	<p>To perform basic civilian administrative functions where and as long as required;</p> <p>To maintain civil law and order, including the establishment of local police forces;</p> <p>To protect and promote human rights and assure the safe return of all displaced people to their homes;</p> <p>To support humanitarian and disaster relief aid and the reconstruction of key and other economic infrastructure;</p> <p>To establish and oversee the development, consolidation and ulterior transfer of provisional self-governing institutions;</p> <p>To facilitate the political process towards status, in full account of the principles contained in Annex 2 of resolution 1244 (1999) and the Rambouillet Accords;<sup>29</sup></p> <p>At a final stage, to oversee the transfer of authority from Kosovo's provisional institutions to institutions established under a political settlement.</p>

**Propozimi Gjithëpërfshirës  
për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës**

**2 shkurt 2007**

## ANEKSI VIII SEKTORI I SIGURISË NË KOSOVË

### **Neni 1            Siguria në Kosovë**

1.1.Përveç aty ku është specifikuar në këtë Marrëveshje, Kosova do të ketë kompetenca mbi zbatimin e ligjit, sigurisë, drejtësisë, sigurisë publike, inteligjencës, organeve civile emergjente dhe kontrollit të kufijve në territorin e saj.

1.2.Institucionet e sigurisë në Kosovë do të operojnë në përputhshmëri me standardet demokratike dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve saj, ashtu siç është paraparë në Aneksin II.

1.3.Kosova do të themelojë një komision parlamentar për mbikëqyrje të sektorit të sigurisë në përputhshmëri me këtë Marrëveshje.

1.4.Kosova do të themelojë Këshillin e Sigurisë të Kosovës (KSK), i cili i raporton kryeministrit. KSK zhvillon strategjinë e sigurisë në përputhshmëri me këtë Marrëveshje. Kosova do të hartoj kornizë legjislative mbi komponentët e sektorit të sigurisë në përputhshmëri me këtë Marrëveshje, me dispozita të duhura buxhetore dhe të mbikëqyrjes.

1.5.Në ato fusha të sektorit të sigurisë ku vazhdon përfshirja ndërkombëtare në përputhshmëri me këtë Marrëveshje, Kosova, në bashkëpunim me PCN-në dhe PUN-në, me kohë, do të zhvillojë strategji për transferim të plotë të përgjegjësisë te autoritetet kosovare.

1.6.Procesi i zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë do të jetë plotësisht transparent ndaj fqinjëve të Kosovës, dhe Kosova do të themelojë masa të duhura të ndërlidhjes dhe ndërtimit të besimit me homologët e saj rajonal.

1.7.Kosova do të përmbushë standardet e OKB-së, OSBE-së dhe BE-së dhe praktikat në fushën e sigurisë dhe kontrollit të armëve, si dhe marrëveshjet tjera rajonale dhe deklaratat nën fushëveprimin e OSBE-së.

### **Neni 2            Policia**

2.1. Një zinxhir i unifikuar i komandës së shërbimeve policore do të ruhet në gjithë Kosovën.

2.2. Kufijtë e stacioneve policore rajonale do të jenë të njëjta me kufijtë komunal.

2.3. Përbërja etnike e policisë brenda komunës do të reflektoj përbërjen etnike të popullatës në komunë, deri në masën e mundshme.

2.4 Këshillat e përbërë nga përfaqësuesit komunal dhe të policisë duke përfshirë edhe komandantët e stacioneve do të bëhen plotësisht funksional në mënyrë që të lehtësojnë



bashkëpunimin në mes të Shërbimit Policor dhe autoriteteve komunale / udhëheqësve lokal të komunitetit. Këshillat udhëhiqen nga Kryetarët e Komunave.

2.5. Komandantët e Stacioneve Lokale informohen paraprakisht për operacionet nga forcat policore qendrore apo speciale brenda perimetrit të stacioneve policore lokale përveç nëse kërkesat operacionale kërkojnë ndryshe.

2.6. Në komunat me shumicë serbe në Kosovë, komandantët e stacioneve lokale zgjedhën sipas procedurës në vijim: Kuvendi Komunal propozon së paku dy emra për komandant stacioni të cilët i përmbushin kërkesat minimale të profesionit ashtu siç është paraparë në legjislacionin e Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme mund të emëroj një kandidat nga kjo listë brenda 15 ditëve të pranimit të listës. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk pranohen nga ministria, Kuvendi Komunal do të sigurojë listën e dytë me së paku dy kandidatë të ndryshëm për shqyrtim nga ministria, të cilët janë nga radhët ekzistuese të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të cilët përmbushin të gjitha kërkesat minimale të profesionit ashtu siç kërkohet nga legjislacioni i Kosovës. Ministria pastaj obligohet që të emëroj një kandidat nga lista e dytë brenda 15 ditëve të pranimit saj.

### **Neni 3 Kufiri**

3.1. Kosova në koordinim me PCN-në dhe PUN-në zhvillon një strategji për mundësimin e dorëzimit e përgjegjësive, me faza, për kontroll të kufijve dhe udhëheqjes së tyre të asociuar dhe integruar në Shërbimin Policor të Kosovës.

3.2. Territori i Kosovës do të definohet nga vija kufitare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ashtu siç kanë qenë këto vija kufitare më 31 dhjetor 1988, përveç ndryshimit të vijës kufitare nga marrëveshja e demarkacionit në mes të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë më 23 shkurt 2001.<sup>7</sup>

3.3. Kosova do të angazhohet me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për themelimin e një komisioni të përbashkët teknik brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, për të përkufizuar vijën fizike të kufirit dhe për adresimin e çështjeve tjera që dalin nga zbatimi i marrëveshjes së vitit 2001 në mes të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Puna e komisionit teknik do të përfundojë brenda një viti nga data e themelimit saj. PCN dhe PUN do të përfaqësohen në këtë komision për të lehtësuar diskutimet në mes të dy palëve, ata mund të marrin pjesë në procesin e demarkacionit të kufirit me kërkesë të cilësdo palë.

### **Neni 4 Shërbimet e Inteligjencës**

4.1. Kosova do të themeloj një agjencion vendor të sigurisë për të mbikëqyrur kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme në Kosovë, në përputhshmëri me Aneksin IX.

<sup>7</sup> Në deklaratën e tij të 7 marsit 2001, kryesuesi i Këshillit të Sigurimit, ndër të tjera përmendi: “Këshilli i Sigurimit bën thirrje për nevojën e respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në këtë kontekst thekson se marrëveshja mbi demarkacionin e kufirit, e nënshkruar në Shkup më 23 shkurt 2001... duhet të respektohet nga të gjithë.”

## **Deklarata e Pavarësisë së Kosovës**

*Të mbledhur në mbledhje të jashtëzakonshme më 17 shkurt 2008, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë,*

*Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afirmon krenarinë dhe synimet e qytetarëve të saj,*

*Të zotuar për t'u përballur më trashëgiminë e dhembshme të së kaluarës së afërt në frymë të pajtimit dhe faljes,*

*Të përkushtuar ndaj mbrojtjes, promovimit dhe respektimit të diversitetit të popullit tonë,*

*Duke riafirmuar dëshirën tonë për t'u integruar plotësisht në familjen euroatlantike të demokracive,*

*Duke vërejtur se Kosova është një rast special që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është presedan për cilëndo situatë tjetër,*

*Duke rikujtuar vitet e konfliktit dhe dhunës në Kosovë që shqetësuan ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar,*

*Mirënjohës që bota intervenoi më 1999 duke hequr në këtë mënyrë qeverisjen e Beogradit mbi Kosovën, dhe vendosur Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara,*

*Krenarë që Kosova që atëherë ka zhvilluar institucione funksionale, multietnike të demokracisë që shprehin lirisht vullnetin e qytetarëve tanë,*

*Duke rikujtuar vitet e negociatave të sponsorizuara ndërkombëtarisht ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mbi çështjen e statusit tonë të ardhshëm politik,*

*Duke shprehur keqardhje që nuk u arrit asnjë rezultat i pranueshëm për të dyja palët përkundër angazhimit të mirëfilltë të udhëheqësve tanë,*

*Duke konfirmuar se rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, i ofrojnë Kosovës një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e saj të ardhshëm, dhe janë në vijë me standardet më të larta europiane për të drejtat të njeriut dhe qeverisjen e mirë,*

*Të vendosur që ta shohim statusin tonë të zgjidhur në mënyrë që t'i jipet popullit tonë qartësi mbi të ardhmen e vet, të shkohet përtej konflikteve të së kaluarës dhe të realizohet potenciali i plotë demokratik i shoqërisë sonë,*

*Duke nderuar të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën,*

1. Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

2. Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

3. Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

4. Ne do të miratojmë sa më shpejt që të jetë e mundur një kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definohej me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.

5. Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Europian. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë.

6. Për arsye të kulturës, gjeografisë dhe historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen europiane. Për këtë arsye, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin Europian sapo që të jetë e mundur dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim europian dhe euroatlantik.

7. Ne i shprehim mirënjohje Organizatës së Kombeve të Bashkuara për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas lufte dhe ndërtimin e institucioneve të demokracisë. Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me Organizatën e Kombeve të Bashkuara gjersa ajo vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.

8. Me pavarësinë vie detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë dhe do t'i përmbahemi parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit, akteve tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtarë ashtu siç janë paraparë në Aneksin VIII të Planit të Ahtisaarit, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të të gjithë fqinjve tanë. Kosova, po ashtu, do të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jokonsistente me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

9. Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

10. Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Europës Juglindore. Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të lejonte Europën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit. Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për të avansuar të ardhmen tonë të përbashkët europiane.

11. Ne shprehim, në veçanti, dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike, tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë më tej në të ardhmen e afërt. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'i kontribuar marrëdhënieve të fqinjësisë dhe bashkëpunimit me Republikën e Serbisë duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.

12. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitatat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.

# **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

## **Kapitulli I                    Dispozitat Themelore**

### **Neni 1                    [Përkufizimi i Shtetit]**

1. Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm.
2. Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.
3. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.

### **Neni 2                    [Sovraniteti]**

1. Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
3. Republika e Kosovës, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, mund të marrë pjesë në sisteme të sigurisë ndërkombëtare.

### **Neni 3                    [Barazia para Ligjit]**

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.
2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

### **Neni 4                    [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]**

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 5 [Gjuhët]**

1. Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.
2. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.

#### **Neni 6 [Simbolet]**

1. Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj.
2. Pamja, mënyra e përdorimit dhe mbrojtja e flamurit dhe të simboleve të tjera shtetërore rregullohen me ligj. Mënyra e përdorimit dhe e mbrojtjes së simboleve kombëtare rregullohet me ligj.

#### **Neni 7 [Vlerat]**

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

**Neni 8 [Shteti Laik]**

Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.

**Neni 9 [Trashëgimia Kulturore dhe Fetare]**

Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare.

**Neni 10 [Ekonomia]**

Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

**Neni 11 [Valuta]**

1. Në Republikën e Kosovës si mjet i vlefshëm pagese përdoret një valutë e vetme.
2. Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës është i pavarur dhe quhet Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

**Neni 12 [Pushteti Lokal]**

1. Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat.
2. Organizimi dhe kompetencat e njërive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj.

**Neni 13 [Kryeqyteti]**

1. Kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina.
2. Statusi dhe organizimi i kryeqytetit rregullohet me ligj.

**Neni 14 [Shtetësia]**

Fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me ligj.



#### **Neni 15 [Shtetasit jashtë Vendit]**

Republika e Kosovës mbron interesat e shtetasve të saj jashtë vendit, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

#### **Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës]**

1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.
2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.
3. Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.
4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.

#### **Neni 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare]**

1. Republika e Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtarësohet në organizata ndërkombëtare.
2. Republika e Kosovës merr pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut.

#### **Neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]**

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:
  - (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
  - (2) të drejtat dhe liritë themelore;
  - (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
  - (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER  
SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR

Nr. Prot. 1784/2  
Prot. No. 1784/2  
Data: 30/06/2015  
Datum: 30/06/2015  
Prishtine, 30/06/2015

Niveli Org. 02.1.a  
Org. Unit  
Nr. Dokumenti -04-  
Doc. No.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**  
**Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General**

Prishtinë, 30 qershor 2015

Ref: 208/2015

**Për:** Z. Murat Meha, Kryetar i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror

**Lënda:** Njoftim me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës

I nderuar z. Meha,

Në bashkëngjijtje të kësaj shkrese, Ju njoftojmë me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës me nr. protokoli 1784 të datës 29 qershor 2015.

Për informata dhe sqarime shtesë, si gjithnjë, qëndrojmë në dispozicionin tuaj.

Me respekt,

Fitim Krasniqi  
Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
 ZYRA E KRYEMINISTRI - UREDI PREMIERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER  
 SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR

Nr. Prof. /  
 Nr. Prof. /  
 Prof. No. /  
 1784

Data /  
 Datum /  
 Date: /  
 29/06/2015

Prishtinë / a



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
 KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
 SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA  
 ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO

Zyra për Propozime dhe Poroshitese-Kancelaria za Predlogi i Predstavica-Table Office

Nr. Prof. /  
 Nr. Prof. /  
 Prof. No. /  
 09/10/17/2015

Data /  
 Datum /  
 Date: /  
 29-06-2015

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
 Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V  
 Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit, pas interpelancës së zhvilluar me ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me procesin e demarkacionit të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, në seancë plenare, të mbajtur me 25 qershor 2015, miratoi këtë:

**REZOLUTË**

1. Referenca juridike dhe faktike e caktimit të kufijve të jetë vija kufitare sipas ndarjes administrative, siç ka qenë e paraparë me ligjin në fuqi për kufijtë administrativë të ish-RSFJ-së, Kufiri i përcaktuar i territorit të Kosovës i vitit 1974 dhe Kushtetutës së sotme të Republikës së Kosovës.
2. Kuvendit dhe komisioneve përgjegjëse t'u dorëzohen me shkrim: dosja, hartat dhe analizat lidhur me demarkacionin e kufirit të Kosovës me Malin e Zi.
3. Kryeministri Isa Mustafa të ndërmarrë masa që Komisioni shtetëror për shënimin e kufirit me Malin e Zi t'i bëjë sa më parë publike të gjitha diskutimet dhe çështjet e parashtruara nga pala malazeze.
4. Qeveria të raportojë në Kuvend para miratimit të elaboratit ndërkufitar Kosovë - Mali i Zi.
5. Qeveria të ndërmarrë masa që secili banor i zonës ku pritet të bëhet demarkacioni t'i ketë hartat dhe sqarimet e nevojshme për pronat e veta.
6. Komisioni shtetëror për shënimin e kufirit me Malin e Zi të ftohet për raportim në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme.
7. Të fillojë demarkacioni i kufirit me Serbinë, sipas kufijve të përcaktuar të territorit të vitit 1974.

Nr. 05-R-03  
 Prishtinë, më 25 qershor 2015

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

CC:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare,
- Arkivit të Kuvendit.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË  
I.Numër: 06 – 34000  
Pejë, dt.18 Mars 2015.

Kryetarit të Komisionit Qeveritar për Demarkacion  
Z.Murat Meha

PRISHTINË

Në takimin e jashtëzakonshëm të Kuvendit Komunal Pejë, të mbajtur me date: 13. Mars 2015, në të cilën u trajtua vetëm një pike e rendit të ditës :

-Informim lidhur me çështjen e demarkacionit të kufirit mes Republikës së Kosovës dhe Malit të zi, pjesës që përfshinë me demarkacion Komunen e Pejës.

Në këtë takim prezantuat edhe Ju dhe informuat këshilltarët komunal lidhur me çështjen në fjalë.

Në bazë të informimit dhe diskutimit, në këtë takim u nxor Konkluzioni I.Numër: 06 – 34000, datë 13 Mars 2015, të cilin e keni të bashkangjitur këtij akti.

Shtoiçë: Konkluzioni.



KRYESUESI,  
Dr.Islam Husaj



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28.datë: 04.qershor 2008”) dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e jashtëzakonshëm të mbajtur me datë: 13.Mars 2015, pas informimit dhe diskutimit lidhur me çështjen e Demarkacionit të kufirit mes Kosovës dhe Malit të zi, për pjesën që përfshin me demarkacion Komunën e Pejës, nxjerrë këtë

KONKLUZION

- I. Kërkohej nga institucionet e Republikës së Kosovës, Presidentja, Kuvendi i Kosovës dhe Qeverija, që me rastin e demarkacionit të kufirit mes Kosovës dhe Malit të zi, çështja të trajtohet konformë Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, që procesi i demarkacionit të jetë plotësisht transparent për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe posaqerisht për zonat që përfshihen dhe janë pjesë e demarkacionit.
- II. Kërkohej që Komisioni shtetror për shënimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetror, që gjatë procesit në zbatim të demarkacionit të kufirit të marrë parasysh të gjitha të dhenat shtetrore dhe arkivore, kadatsrale si dhe të dhenat që disponon Komuna e Pejës, dhe qytetarët e saj, e që janë relevante për shqyrtim dhe vendosje të drejtë të vijës kufitare, që të mirren në shqyrtim nga komisioni dhe që njëkohësisht të interpretohen drejtë e të njoftohen qytetarët dhe institucionet komunale lidhur me qendrimin e komisionit për faktet e ofruara.
- III. Gjatë procesit të demarkacionit të kufirit Komisioni duhet të marrë parasysh seriozisht shqetësimet e banorëve, respektivisht të pronarëve të paluajtshmerive dhe pronat publike që gjenden në zonat që përfshihen me demarkacion.
- IV. Me rastin e shenimit të kufirit tani ndërshtetror në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të zi, Komisioni njëkohësisht duhet të ketë parasyshë ndarjen administrative kufitare nga vitit 1974 dhe të ketë varijantin e tij për demarkacion të kufirit, duke respektuar të drejten universale mbi të drejten e pronës.
- V. Kuvendi i Komunës së Pejës, Ju ben thirje institucioneve qendrore që të rishikojnë punën e deri tanishme të Komisionit, për shënimin dhe mirëmbajtjen e kufirit.
- VI. Nëse vendoset demarkacioni në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të zi, në demë të qytetarëve, për ne si Komunë, do të jetë I pa pranushëm një vendim i till.
- VII. Ky konkluzion hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi.

I.Numër: 06 - 34000

Pejë, date: 13. Mars 2015.



KRYESUESI,  
Dr.Islam Husaj

Dekret për shpalljen e Ligjës mbi Matjen e Kadastrën e Tokave, KSAK,

KK Nr. 92-5, Prishtinë 13 Prill 1973

Në bazë të nenit 116 të Ligjës Kushtetuese të  
Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, jap

## DEKRET

### PER SHPALLJEN E LIGJËS MBI MATJEN E KA- DASTRËN E TOKAVE

Shpallët Ligja mbi matjen e kadastrën e tokave,  
të cilën e aprovoi Kuvendi i Krahinës Socialiste  
Autonome të Kosovës në mbledhjen e Dhomës kra-  
hinore më 13 prill 1973. dhe mbledhjen e Dhomës  
organizative-politike më 13 prill 1973.

KK Nr. 95-2  
Prishtinë, 13 prill 1973

Kryetari i Kuvendit,  
Ilijaz Kurteshi, d. v.

## LIGJA

### MBI MATJEN E KADASTRËN E TOKËVE

#### L DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1


Matja e tokëve, përpilimi i kadastrës së tokëve  
dhe mirëmbajtja e përtrirja bëhet në mënyrën dhe  
sipas procedurës se caktuar me këtë Ligjë dhe me  
dispozitat e nxjerra në bazë të saj.

##### Neni 2

Matja e tokëve (në tekstin e mëtejshëm: matja)  
bëhet për të gjetur shënime të nevojshme për pas-  
qyrën horizontale e vertikale të terrenit të territorit  
të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (në  
tekst të mëtejshëm: Krahina) — me qëllim shfry-  
tëzimi të këtyre shënimeve për qëllime ekonomike,  
shkencore dhe administrative, si dhe për nevojat  
të tjera të organeve shtetërore, organizatave punic-  
se dhe organizatave të tjera e qytetarëve.


## Harta pasqyruese e planifikimit dhe realizimit të matjeve të territorit të KSA të Kosovës, e botoi Drejtoria për Gjeodezi e KSA të Kosoves në vitin 1973

Kufiri i KSA të Kosovës me Republikën e Malit të Zi, Sërbisë Maqedonisë dhe Shqipërisë identik me të tanishmin 2015.



**Harta pasqyruese e territorit të KSA të Kosovës, e botoi Drejtoria për Gjeodezi e KSA të Kosoves në vitin 1974**

Kufiri i KSA të Kosovës me Republikën e Malit të Zi, Sërbisë Maqedonisë dhe Shqipërisë identik me të tanishmin 2015.





Ligjit i Matjes dhe i Kadastrit të Tokave, KSAK,

Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr 12, Faqe 393

12 Mars 1980

## L I G J I

### I MATJES DHE I KADASTRIT TË TOKAVE

#### I — PJESA E PËRGJITHSHME

##### Neni 1


Matja e tokave, hartimi i kadastrit të tokave, si dhe mirëmbajtja dhe përrirja e tyre bëhet në mënyrën dhe sipas procedurës së përcaktuar me këtë ligj dhe me dispozitat e nxjerra në bazë të tij.

##### Neni 2

Matja e tokave (në tekstin e mëtejshëm: matja) bëhet me qëllim të përcaktimit të të dhënave të nevojshme për paraqitjen horizontale dhe të lartësisë së terrenit të territorit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Krahina) me qëllim të shfrytëzimit të këtyre të dhënave për qëllime ekonomike, teknike, shkencore dhe administrative, si dhe për nevojat tjera të organeve, të organizatave të punës së bashkuar, të organizatave e të bashkësive tjera vetëqeverisëse dhe të qytetarëve.

## Harta e seksioneve trigonometrike të territorit të KSA të Kosovës, e botoi Drejtoria për Gjeodezi e KSA të Kosovës në vitin 1979

Kufiri i KSA të Kosovës me Republikën e Malit të Zi, Sërbisë Maqedonisë dhe Shqipërisë identik me të tanishmin 2015.



RREGULLORE NR. 2000/43

UNMIK/REG/2000/43

27 korrik 2000

## **Mbi numrin, emrat dhe kufinj të komunave**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin e tij të dhënë me rezolutën 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,

*Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror  
Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice  
State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders*

---

### **Nënshkrimi i marrëveshjes për demarkacion e kufirit ndërmjet te Republikës se Kosovës dhe Malit të Zi në Vjenë**



Në mbledhjen e 44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mbajtur me 12 Gusht 2015, unanimisht u aprovua raporti i punës me dokumentacionin zyrtar të Komisionit Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror.

Kosova dhe Mali i Zi, me 26 gusht 2015 nënshkruan në Vjenë marrëveshjen për kufirin shtetëror ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Marrëveshja u nënshkrua për Republikën e Kosovës nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm, Hashim Thaçi, dhe ministri i Brendshëm, Skënder Hyseni dhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm i Malit të Zi, Igor Llukshic, e ministri i Brendshëm, Rashko Konjevic për Malin e Zi. Akti i nënshkrimit në Vjenë shihet në foto të bashkëngjitur.

Në një njoftim të Ministrisë së Jashtme të Kosovës, thuhet se dëshmitarë të nënshkrimit ishin kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, kryetari i Malit të Zi, Fillip Vujanoviq, si dhe ministri i Jashtëm i Austrisë, Sebastian Kurz.

Ministri i Jashtëm i Kosovës, Hashim Thaçi, pas nënshkrimit të marrëveshjes tha se ajo është në "përputhje të plotë me Kushtetutën e vitit 1974, Dokumentin e Presidentit Martti Ahtisaari dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo është një ditë e rëndësishme për Kosovën, për Malin e Zi por edhe për tërë rajonin, që dëshmon se rajoni ka hyrë në një periudhë të bashkëpunimit dhe po ecën sigurt në rrugën e integrimeve euro-atlantike"

26 Gusht 2015

## Deklarata nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barack Obama

**18 Shtator 2015**

### **Obama e quan akt historik marrëveshjen për demarkacion Kosovë – Mali i Zi**



Marrëveshja për demarkacionin kufitar me Malin e Zi e nënshkruar me 26 gusht nga ministri i Punëve të Jashtme, Hashim Thaçi dhe ai i Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni edhe pse ka ngjallur reagime të shumta te opozita, shoqëria civile dhe banorët e komunave Pejë, Deçan dhe Istog, të cilët thonë se me këtë marrëveshje Kosova humb 12 mijë hektarë, ajo marrëveshje është mirëpritur nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barack Obama.

Ai e ka quajtur akt historik nënshkrimin e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malin e Zi gjatë takimit që ka zhvilluar me ambasadoren e re të Kosovës në SHBA, Vlora Çitaku, e cila i ka dorëzuar letrat kredenciale.

*“Nënshkrimi i marrëveshjes historike për demarkacionin e kufirit në mes Kosovës dhe Malit të Zi me 26 gusht, demonstroi edhe më tutje përcaktimin e Kosovës për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe vendosshmërinë tuaj, që çështjet rajonale të adresohen në frymën e dialogut dhe bashkëpunimit. Përcaktimi i Kosovës që sfidat e lartpërmendura t’i adresojë në mënyrë të përgjegjshme dhe konstruktive ka vënë Kosovën në një rrugë solide drejt rritjes së stabilitetit, sigurisë dhe prosperitetit në një Evropë të plotë, të lirë dhe në paqe”,* ka thënë Obama.

Sipas tij, ka shumë punë në rrugën drejt fuqizimit të demokracisë dhe ekonomisë dhe drejt integritimit në Institucionet rajonale dhe ndërkombëtare gjersa ka shtuar se SHBA-të do të vazhdojnë mbështetjen për Kosovën në këto sfida dhe në sfida tjera.

*“Kosova ka ndërmarrë disa vendime të vështira dhe sfiduese këtë verë. Këto vendime kanë avancuar perspektivën evro-atlantike të Kosovës. Ne përgëzojmë Qeverinë e Kosovës dhe Parlamentin për miratimin e amendamenteve Kushtetuese dhe legjislacionit për themelimin e gjykatës së speciale, e cila do t’i adresojë krimet e pretenduara, pas konfliktit në Kosovë në vitin 1999.*

*Ky veprim, ka qenë vendimtar në afërmimin e Kosovës, si shtet i përcaktuar për rend, ligj dhe pajtim. Lidërshipi juaj, po ashtu ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënieve me fqinjin tuaj Serbinë. Këto marrëveshje do të fuqizojnë shtetin tuaj dhe do të çimentojnë paqen dhe stabilitetin në rajon”, ka thënë Obama.*

Ambasadorja e Republikës së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Vlora Çitaku, e cila i dorëzoi letrat kredenciale presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barack Obama, në emër të presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, i përcolli urimet më të sinqerta për presidentin Obama dhe popullin amerikan dhe njëkohësisht shprehi përkushtimin dhe vendosmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për thellimin dhe avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dy-palëshe në mes dy vendeve dhe dy popujve.

Ceremonia zyrtare e dorëzimit të letrave kredenciale u zhvillua në Shtëpinë e Bardhë.

## Deklarata e Departamentit të Shtetit Amerikan

21 Dhjetor 2015

**SHBA: Demarkacioni i Kosovës me Malin e Zi është në rregull (Dokument)**



Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë ka njoftuar se Departamenti Amerikan i Shtetit ka shqyrtuar vijën kufitare ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi të përgatitur nga Komisioni Shtetëror i Kosovës për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror.

“Ne e kuptojmë që baza për Komisionin për Demarkacion ishte Kushtetuta Jugosllave 1974, e cila përcakton kufirin e Kosovës nga kufijtë administrativ të komunave, të cilat janë të ndara në zona kadastrale. Kjo bazë e përshkrimit është përdorur edhe në Propozimin Gjithëpërfshirës për Statusin në vitin 2007 e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara Martti Ahtisaari dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës 2008”, shkruan në komunikatën e ambasadës amerikane.

Sipas ambasadës, pas një shqyrtimi të hartave të viteve 1940 deri më sot, duke përfshirë edhe ato të përdorura nga komisioni për shënimin e kufirit, Departamenti i Shtetit Amerikan ka arritur në përfundim që vija kufitare e përcaktuar nga Komisioni për Demarkacion është me një vijë me atë të Kushtetutës së vitit 1974.

“Kufijtë e përshkruar që nga viti 2008 përputhen plotësisht me propozimin e vitit 2015 deri në detaje. Ne konstatojmë se përfundimi i marrëveshjes së demarkacionit të kufirit është një kusht i BE-së për liberalizimin e vizave dhe paraqet një hap të rëndësishëm në rrugën e Kosovës drejt integritimit evropian”, thuhet në konstatimin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

## **Statement on Kosovo-Montenegro Border Demarcation Report**

December 21, 2015

The U.S. Department of State has reviewed the detailed delimitation line of the Kosovo-Montenegro border prepared by the Kosovo State Commission for Marking and Maintenance of the State Border. We understand the basis for the Commission's demarcation effort was the 1974 Yugoslav Constitution, which defined Kosovo's border from the administrative borders of municipalities, which are broken into cadastral zones. This basis of delineation was also used in the 2007 Comprehensive Settlement Proposal of UN Special Envoy Martti Ahtisaari and the 2008 Constitution of the Republic of Kosovo.

Following a review of the maps from the 1940s to the present, including those used by the commission demarcating the border, the State Department has determined the recently-delimited border closely aligns with the border as defined by the 1974 Constitution. The borders we have depicted since 2008 match the proposed border of 2015 in detail. We note that conclusion of the border demarcation agreement is an EU condition for visa liberalization and represents an important step in Kosovo's path toward European integration.



## Raporti final i ekspertëve ndërkombëtarë për demarkacion me Malin e Zi

Bota Sot | 31.03.2016 14:49



Raporti final i ekspertëve ndërkombëtarë të angazhuar nga presidentja e Kosovës për të verifikuar punën e Komisionit Shtetëror të Kosovës për caktimin e kufirit me Malin e Zi, vë në pah se demarkacioni i kufirit me Malin e Zi është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare ashtu siç është thënë dje nga vet ekspertët në një konferencë për media të cilën ata e kanë mbajtur bashkë me Presidenten e Kosovës.

Në raportin, ekspertët nuk kanë lënë pa i përmendur edhe shqetësimet dhe kërkesat e opozitës, të cilat muajve të fundit kanë protestuar disa herë, me arsyetimin se Kosova po humb mijëra hektar nga demarkacioni me Malin e Zi.

Aty thuhet se sipas gjetjeve, pretendimet për “territorin e real” ose “linjat natyrore”, pa baze ligjore, mund të jenë çorientuese dhe hartat historike

dhe ato tematike pa bazë ligjore, mund të kenë vendin e tyre në ndonjë klasë, por nuk qëndrojnë në sallën e gjyqit.

## **Lexoni raportin final të ekspertëve në gjuhën shqipe:**

### **RAPORTI FINAL I KOMISIONIT AD HOC**

Komisioni Ad Hoc ka arritur në përfundimin se, bazuar në kriteret teknike dhe ligjore, procesi i Kosovës për përcaktimin e kufirit me Malin e Zi , në mënyrë të qartë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Më 15 mars 2016, Presidentja e Republikës së Kosovës ka themeluar Komisionin Ad Hoc të përbërë nga tre ekspertë ndërkombëtarë, Fletcher M. Burton, Frederick Neëton, Herbert Wilmes, të cilët kanë përvojë shumëvjeçare profesionale dhe praktike që ka të bëjë me kufijtë në Evropë, rajon dhe Kosovë.

Presidentja e ka mandatar Komisionin Ad Hoc për të shqyrtuar dhe vlerësuar punën e Komisionit Shtetëror për caktimin dhe dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror - në veçanti, procesin me të cilin Komisioni Shtetëror bashkëpunoi me trupin homolog nga Republika e Malit të Zi për të arritur marrëveshje për kufirin e tyre të përbashkët. (Të cilit do ti referohemi si Procesi i Kosovës).

Të dy komisionet shtetërore së bashku, u takuan në 16 seanca dyditore gjatë periudhës prej vitit 2012 deri më 2015.

Takimet e tyre janë kryer në vende të ndryshme në Kosovë dhe Mal të Zi, me protokollet e nënshkruara reciprokisht dhe me kryesues institucionin që ka qenë nikoqir i takimit.

Të dy shtetet, të përfaqësuara në nivel ministror, nënshkruan Marrëveshjen në Vjenë më 26 gusht të vitit 2015.

### **PIKËPAMJET E KOMISIONIT AD HOC**

Në cilësinë tonë si Komision Ad Hoc, duke ndjekur mandatin tonë në periudhën 15-29 mars 2016. Ne prezantuam raportin final, në formën e tanishme me gjetjet dhe rekomandimet më datën 30 mars te Presidentja e

Kosovës.

Gjatë punës sonë, ne kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyer me të gjithë kosovarët që kanë pasur një interes profesional, institucional, politik apo personal – për marrëveshjen e kufirit me Malin e Zi. Palët ndërkombëtare, nga komuniteti ushtarak dhe diplomatik në Prishtinë ka bashkëpunuar në mënyrë gjeneroze.

Ne dëshirojmë të shprehim falënderimin tonë të veçantë për Presidenten e Kosovës dhe ekipin e saj për mbështetjen e tyre të jashtëzakonshme.

Komisioni Ad Hoc ka mbajtur konsultime të gjera dhe intensive në kryerjen e këtij studimi.

Ne u kemi kushtuar vëmendje të veçantë dokumenteve dhe hartave përkatëse. Liderët shtetërorë, qeveritar dhe të partive të nivelit më të lartë po ashtu kanë shpalosur pikëpakjet e tyre për ne.

Më 23 mars, ne kemi udhëtuar për në rajonin kufitar të takohemi me kryetarët e komunave dhe qytetarët e interesuar.

Informatat e para i kemi marrë për zonën e kufirit Çakor dhe Kulla.

Në të vërtetë, ne u përqendruam shumë në hetimin tonë në Çakor dhe Kullë, dy pika mjaft të kontestuara.

Nga qytetarët kuptuam ndjenjat e thella që ndërlidhen me këtë çështje – sikur që ndodhë në gjithë botën, sidomos kur bëhet fjalë për ndarje të kufirit.

Të katër kryetarët e komunave që lidhen me një vijë administrative me Malin e Zi janë takuar me ne për të diskutuar marrëveshjen për kufirin. Ata kanë prezantuar dy palët edhe qeverinë edhe opozitën. Dy nga ta ndanë me ne rezolutat e Kuvendeve Komunale që adresojnë këtë çështje.

Gjatë konsultimeve tona me përfaqësuesit e KFOR'it, ne konfirmojmë se hartat e KFOR'it që tregojnë linjën e kufirit Kosovë-Mali të Zi, janë të njëjta me ato që na u dorëzuan nga komisionet shtetërore.

Ne konfirmuam se hartat e qeverisë amerikane tregojnë se ky kufi është shumë i përafërt me kufijtë e njëjtë të komunave.

## **MENAXHIMI NDËRKOMBËTAR I KUFIRIT**

Është jetike që të dyja vendet të përfitojnë nga rezultatet e këtij Komisioni Ad Hoc për të shtuar protokollet e punës nëpërmjet etablimit të standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë çështjet si vijojnë:

- Të dy agjencitë kufitare të veprojnë në të njëjtën ndërtesë, objekt, më pajisje të njëjta të kërkimit;
- Vendosja e një ANPR (Radar Automatik për Numërim të Zonës) të përbashkët dhe sistemet e teknologjisë CCTV (Kamera për vëzhgim);
- Menaxhimi i Inteligjencës;
- Vlerësimet strategjike të rrezikut;
- Vlerësimet strategjike të kërcënimeve; dhe
- Kryerja e detyrave dhe koordinimit në një mjedis të kombinuar.

Duke miratuar një qasje të tillë, dy shtetet fqinje do të krijojnë më shumë bashkëpunim, efektivitet dhe efikasitet në punë.

Ne kemi vazhduar konsultimet tona në Podgoricë në Malin e Zi, këtë herë më zyrtarët malazezë.

Më 25 mars u takuam me Komisionin Shtetëror të Malit të Zi, i cili kishte shërbyer si organ partner në ushtrimin e këtij procesi.

Ky diskutim i përbashkët na ndihmoi ta kuptojmë procesin tonë të kësaj marrëveshje, veçanërisht në lidhje me aspektet ligjore dhe teknike.

Edhe pse mandati ynë ishte i përqendruar në Procesin e Kosovës, konsultimi me palën malazeze iu është bashkangjitur kësaj rëndësie.

Ne jemi mirënjohës që bashkëpunuam me këtë palë.

## **GJETJET**

Konstatimi ynë kryesor, i vendosur edhe në fillim të këtij raporti, thotë në vijim:

Komisioni Ad Hoc ka arritur në përfundimin se, në bazë të ligjeve dhe në bazë të kriterëve teknike, procesi i përcaktimit të kufirit me Malin e Zi në Kosovë është plotësuar me standardet ndërkombëtare në mënyrën më të qartë.

Në dimensionin ligjor, kemi nxjerrë në pah tri kategori të një rëndësie të veçantë.

### **LIGJSHMËRIA:**

Procesi i Kosovës u vu mbi një bazë të shëndoshë ligjore, e ndërtuar në shtyllat e themelimit të shtetit, duke përfshirë Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974, Planin e Ahtisaarit në vitin 2007, Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 dhe Kushtetutën e Kosovës.

Kufijtë e Kosovës janë nxjerrë nga kufijtë administrativ të komunave, të cilat nga ana tjetër janë ndarë në zonat kadastrale.

Në rastin e kufirit Kosovë-Mali i Zi, komunarët e Junikut, Deçanit, Pejës dhe Istogut, u mblodhën për të përcaktuar kufirin.

Është konstatuar se vija kufitare përputhet me atë që përshkruhet në Planin e Ahtisaarit në Aneksin VIII, 3.2..

Në shqyrtimin tonë të këtij procesi, ne kemi gjetur se pretendimet për “territorin e real” ose “linjat natyrore”, pa baze ligjore, mund të jenë çorientuese.

Hartat historike dhe ato tematike pa bazë ligjore, mund të kenë vendin e tyre në ndonjë klasë, por nuk qëndrojnë në sallën e gjyqit.

Debati për kufirin nuk ka të bëjë vetëm me territorin e shtetit, por edhe me gjendjen e territorit.

Simbolet shtetërore tregojnë territorin e vendit, që është vizatuar nga Procesi i Kosovës.

### **VAZHDIMESIA:**

Në kuadrin ligjor të Kosovës, komunat gjithmonë kanë ekzistuar kufijtë e tyre kanë përfshirë gjithë territorin brenda tyre. Ne kemi gjetur një vazhdimësi të shkëlqyeshme të shënimeve kadastrale, të dekadave të mëhershme, brenda kufijve komunalë.

Tutje kufiri i jashtëm i kufijve komunalë po ashtu tregon prejardhjen e mëhershme që shkon deri te Kushtetutua e vitit 1974 e që ruan stabilitetin deri në ditët e sotme. Ky kufi është vija e njëjtë e përcaktuar me vitin 1974.

Zyrat ku ruhen të dhënat kadastrale, në nivel shtetëror dhe komunalë, janë adresë e duhur për të verifikuar informatat kadastrale. Ne nuk kemi mundur të gjejmë dëshmi se informatat kanë qenë të pakompletuara dhe të falsifikuara. Sidoqoftë, akuzat janë serioze, dhe nëse ka nevojë të adresohen në institucionet legale të Kosovës.

### **PAJTUESHMËRIA:**

Kufiri Shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, siç përcaktohet në marrëveshjen e tyre më qershor të vitit 2015, paraqet sipërfaqen e tokës e cila e ndan territorin e dy shteteve, hapësirën ajrore, hapësirën e tyre nëntokësore dhe hapësirën e sipërfaqes së ujit.

Në konsultimet tona në Podgoricë me komisionin shtetëror të Malit të Zi, ne zbuluam se qasja e njëjte ligjore e përcaktimit të kufirit – ndërtuar nga zonat kadastrale dhe kufijtë komunal, qëndrojnë në baza të njëjta të të dhënave të qëndrueshme nga zona kadastrale.

Kriteret ligjore dhe teknike kanë qenë thelbësore për komisionet shtetërore për përcaktimin e linjës së vetme, si dhe për komisionin Ad Hoc për të gjykuar këtë proces.

### **MATJA:**

Ne kemi gjetur se vija e përcaktuar e kufirit është e bazuar mbi informacione gjeometrike me kufirin administrativ të formuar mes ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe ish- Republika Socialiste të Malit të Zi, kufijtë komunal brenda shtetit të Kosova dhe brenda shtetit të Malit të Zi, vijat kufitare janë në prekje të afërta të të dy vendeve.

Komisioni Ad Hoc ka gjetur se ky përkufizim është vërtetuar në praktikë bazuar në të dhënat gjeometrike. Përkufizimi nga një burim i vetëm, megjithatë, mund të jetë i pasaktë ose mashtrues. Kjo qëndron për shkak të faktit se përkufizimet kufitare të hartave (Kosova dhe Mali i Zi) në shkallën 1: 200 mijë kanë vetëm një rezolutë të kufizuar gjeometrike, por kjo mund të kompensohet për përdorimin e informacionit të mëtejshëm: Kufijtë komunal në fuqi në të dy vendet dhe nëndarje të tyre në zona kadastrale, të cilat mbajnë informacionin më të saktë gjeometrik.

Krijimi i kufijve midis Kosovës - Shqipërisë dhe Kosovës – Maqedoni, janë shembuj klasikë të kombeve që punojnë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët.

Ne kemi gjetur se përvoja e tillë krijon një mjedis të transparencës dhe sjell besim.

### **REKOMANDIME:**

Ne, rekomandojmë që publiku i Kosovës nuk duhet të humbë shikimin nga këto tema të rëndësishme, duke përfshirë edhe përcaktimin e kufirit.

Forcimin e lidhjeve me Malin e Zi: Nga të dyja anët, kemi dëgjuar se dy Komisionet e shteteve kanë punuar në mënyrë profesionale dhe të saktë. Vendimi i Malit të Zi për njohjen e Kosovës si vend sovran, është bërë më 9 tetor të vitit 2008. Të dyja vendet ndajnë një aspiratë për t'u integruar më tej në institucionet euro-atlantike.

Të dyja vendet mund të kontribuojnë në masë të madhe për bashkëpunim më të thellë rajonal.

E rëndësishme është arritja e objektivave të tre kufijve: Policia, Doganat, Ushqimi dhe veterina. Të gjitha këto ndajnë përgjegjësinë për mbledhjen e

inteligjencës dhe kanë aftësinë për të ofruar të dhëna në mënyrë të barabartë.

Komisioni Ad Hoc, ka gjetur se nga praktikat standarde europiane, përgatitja teknike e përcaktimit të kufirit dhe vetë përcaktimi, janë trajtuar si proces konfidencial.

Pas përfundimit të hulumtimit tonë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të regjistrimit, të dyja palët duhet të sigurojnë një kopje shtesë të dokumentacionit kufitar në Kombet e Bashkuara. Traktate të tilla janë regjistruar në Sekretariatit e OKB'së "Traktati i Kombeve Të Bashkuara".



**FINAL REPORT  
OF THE AD HOC COMMISSION  
FOR REVIEWING THE BORDER DELINEATION PROCESS  
BETWEEN  
THE REPUBLIC OF KOSOVO AND THE REPUBLIC OF MONTENEGRO**

SUBMITTED TO THE PRESIDENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

MARCH 30, 2016

PRISTINA, KOSOVO

Fletcher M. Burton

Frederick Newton

Herbert Wilmes

## **SUMMARY**

The Ad Hoc Commission has concluded that, based on the essential legal and technical criteria, the Kosovo Process of delineating the border with Montenegro clearly satisfied international standards.

In the interest of transparency, we append to this report extensive material on the border agreement, furnished from both its supporters and critics. (See Annex.)

## **BACKGROUND**

On March 15, 2016, the President of the Republic of Kosovo established the Ad Hoc Commission of three international experts with many years of professional expertise and practical experience related to borders in Europe, the region and Kosovo itself. (For biographical information, see the presidential announcement in Annex.)

The President mandated the Ad Hoc Commission to review and evaluate the work of the State Commission for Marking and Maintaining of the State Border – in particular, the *process* by which the State Commission collaborated with its counterpart body from the Republic of Montenegro to reach an agreement on their common border. (Hereinafter referred to as the “Kosovo Process.”)

Together the two State Commissions met in 16 two-day sessions during the period of 2012 to 2015. Their meetings were carried out at alternating places in Kosovo and Montenegro with mutually signed protocols and with the hosting institution serving as chair. The two States, represented at the ministerial level, signed the Agreement in Vienna on August 26, 2015.

## **VIEWS OF THE AD HOC COMMISSION**

In our capacity as the Ad Hoc Commission, we pursued our mandate in the period March 15 – March 29, 2016. We presented our Final Report, in its present form with findings and recommendations, on March 30 to the President of Kosovo.

During our work, we enjoyed excellent cooperation from all Kosovars with an interest – professionally, institutionally, politically or personally – in the border agreement. International stakeholders from the diplomatic and military communities in Pristina also cooperated generously. We wish to express our special thanks to the President and her team for their extraordinary support.

Our Ad Hoc Commission held extensive consultations and conducted intensive study. We listened respectfully to all points of view. We paid particular attention to relevant documents and maps. State, government and party leaders in Pristina at the highest level took time to lay out their views to us. On March 23, we traveled to the border region to meet with mayors and interested citizens. On March 24, we drove to the border itself and received thorough briefings in the vicinity first of Çakor and then of Kulla.

Indeed, we focused much of our inquiry on Çakor and Kulla, two contested points. We sought to maintain an impartial view of the dispute, drawing on our collective professional experience and international perspective. We understood from citizens the depth of sentiment involved in the matter – as is often the case, the world over, in border delineations.

All four mayors of the municipalities with an administrative boundary contiguous to Montenegro met with us to discuss the border agreement. They represented parties both in the Kosovo government and in the opposition. Two of them shared with us resolutions from their respective assemblies addressing the border issue, another indication of political and public opinion. (See links below as well as in Annex for resolutions.)

<https://kk.rks-gov.net/peje/News/Advertisement/Takimi-i-jashtezakonshem-i-Kuvendit-te-Pejes.aspx>

<https://kk.rks-gov.net/decan/Shpalljet.aspx>

During our consultations with KFOR representatives, we confirmed that KFOR maps currently in use follow the same line as municipal boundaries of border municipalities in the Kosovo-Montenegro area, also the same line delineated by

the two State Commissions. We confirmed that U.S. Government maps show this border as closely aligned with these same municipal boundaries.

## **INTERNATIONAL BORDER MANAGEMENT**

It is vital that both countries take advantage of the findings of this Ad Hoc Commission to enhance working protocols through the establishment of key international standards, including the following:

- One stop shop i.e. both border agencies operating out of a single building, search facilities and equipment;
- Deployment of a common ANPR (Automatic Number Plate Reader) and CCTV technology systems (Closed Circuit Television);
- Intelligence Management;
- Strategic Risk Assessments;
- Strategic Threat Assessments; and
- Tasking and Co-ordination in a combined multi-agency environment.

By adopting such an approach, the two neighboring States will create much greater cooperation, effectiveness and efficiency.

In Podgorica, Montenegro, we continued our border consultations, this time with Montenegrin officials. We met on March 25 with the State Commission of Montenegro, which had served as the partner body in the delineation exercise. This discussion helped us round out our understanding of the process that led to the agreement, especially in relation to its legal and technical aspects. (See Annex for material provided by the Montenegrin side.)

Although our mandate centered on the Kosovo Process, we attached great significance to consultations with the Montenegrin side. We are grateful for their cooperation. We know from our own prior experience that border delineation is not solely a unilateral enterprise but also a bilateral one; and that it is not simply a bilateral enterprise but ultimately a conjunctive one. Delineation is one line converging from two sides.

## FINDINGS

Our key finding, also placed at the beginning of this report, states the following:

The Ad Hoc Commission has concluded that, based on the essential legal and technical criteria, the Kosovo Process of delineating the border with Montenegro clearly satisfied international standards.

On the *legal* dimension, we highlight three categories of special importance.

*LEGALITY:* The Kosovo Process rested on a sound legal basis, one constructed on the pillars of the State founding, including the 1974 Yugoslav Constitution, the 2007 Ahtisaari Plan, the 2008 Kosovo Declaration of Independence and the 2008 Kosovo Constitution. These charter documents not only formed the independent State but also shaped its territory.

Thus, Kosovo's borders were derived from the administrative boundaries of municipalities, which in turn were broken into cadastral zones. The boundaries of border municipalities defined the State borders. This legal underpinning is an essential part of the very definition of independent Kosovo.

In the case of the Kosovo-Montenegro border, the external boundaries of Junik, Deçan, Peja and Istog came together to define the border. That border line matches the one described in the Ahtisaari Plan in Annex VIII, 3.2., and used in the Kosovo Process.

In our review of that process, we found it useful to start with the law – and it is clear – and then consider maps – and there are many. Claims of “real territory” or “natural lines,” without a legal basis, can be misleading. Thematic and historic maps, without a legal basis, may have a place in a classroom but no standing in a courtroom.

The border debate is not only about the territory of the State but also the State of the territory. The State insignia show the territorial outline of the country, the very line drawn by the Kosovo Process.

*CONTINUITY:* In the legal framework of Kosovo, municipalities always existed and their boundaries encompassed all the territory within them. We found a remarkable continuity of cadastral data, going back decades, within the border municipalities. Further, the external border of the border municipalities also shows a long lineage, reaching back before the 1974 Constitution and remaining stable until the present day. This border is the same line set forth in the Kosovo Process.

The official repositories of cadastral information, at the State and municipal level, are the proper address for verifying cadastral information. We could find no evidence that this cadastral information was incomplete or falsified. The charge, however, is a serious one, best adjudicated if necessary in the legal institutions of Kosovo.

*CONGRUITY:* The State border between Kosovo and Montenegro, as determined in their June 2015 agreement, represents “a plane which transverses vertically the border line on the surface of the Earth and divides the territory of two states, their air space, underground space and the space under the water’s surface” (Article 1, Agreement on the State Border, contained in the Annex).

The two sides had to collaborate to define this vertical plane and its more familiar terrestrial line. We found that they did so as required by the profession of delineation – that is, without gap or overlap. And they did so in a spirit of collaboration and trust.

In our Podgorica consultations with the Montenegrin State Commission, we discovered the same legal approach to defining a border – constructed from cadastral zones and municipal boundaries – and the same stable database of cadastral and municipal information. Their work converged with that of their Kosovo counterparts; their delineated line admitted no no-man’s-land.

The legal and the *technical* criteria were essential for the State Commissions to draw a single line, as well as for our Ad Hoc Commission to judge the process. We emphasize three technical dimensions:

*MEASUREMENT:* We found that the delineated border line is based upon the congruent geometrical information of (1) the administrative boundary formed between the former Socialist Autonomous Province of Kosovo and the former Socialist Republic of Montenegro, (2) the municipal boundaries within the State of Kosovo and within the State of Montenegro in their contiguous touching of the border line, and (3) the cadastral boundary of both states where they meet the neighboring state. The Ad Hoc Commission found that this definition is proven practice based on threefold geometric data.

The definition from one source only, however, could be imprecise or misleading. This would be due to the fact that the boundary definitions of the maps (Kosovo and Montenegro) in scale 1:200.000 have only a limited geometric resolution. But this can be compensated for by using further information: The municipal boundaries in force in both countries and their subdivision into cadastral zones, which hold the most precise geometric information possible. The cadastral zones are one-to-one connected with the municipal area. The registered cadastral database provides the highest accuracy. Therefore, in their combined geometrical information, they allow delineation of the State border and territory of Kosovo at the required centimeter-level, the international standard.

*TECHNOLOGY:* The Kosovo State Commission introduced the most advanced technical equipment and technology available in geodesy for their search of the border delineation. These include GNSS receivers (Global Navigation Satellite Systems) for the most precise surveying purposes, and the GIS technology (Geographic Information System) for the interactive treating of the available maps and for combining cartographic layers and geodetic coordinates.

*PROJECTION:* The State Commission also used Gauss-Krueger coordinates and mathematical transformations to combine the results of modern GNSS surveying with the existing coordinates of the State borders. Further, it allows, at the two trilateral border points with Albania and Serbia at the start and end of the delineation line, the transformation of new geodetic measurements into the existing coordinates and map projections.

The establishment of the borders between Kosovo – Albania and Kosovo – FYR of Macedonia are classic examples of nations working together towards a common aim. There are many similarities with the legal and technical methodologies used in the Kosovo – Montenegro negotiations. We found that such experience creates an environment of transparency and engenders trust.

## **RECOMMENDATIONS**

In our review of the Kosovo Process, we were struck by various dimensions of the border debate that did not receive adequate attention. We therefore recommend that the Kosovo public not lose sight of important themes, including the following, related to border delineation.

*Strengthening ties with Montenegro:* From both sides, we heard that the two State Commissions worked in a professional and correct manner, an example of strong bilateral relations. Montenegro's decision to recognize Kosovo as a sovereign country, done October 9, 2008, was also a dramatic show of support. Both countries share an aspiration to integrate further with Euro-Atlantic institutions. Both can contribute greatly to deeper regional cooperation. In many discussions, we heard Kosovars speak of the importance of relations with its western neighbor and the benefits of their development. A central lesson of the success of the demarcation with Macedonia in October 2009 was to transform the static line into a dynamic relationship. Indeed, on the very same day of final ratification in both parliaments – October 17, 2009 – the two countries established full diplomatic ties. Demarcation was not an end but a beginning. The border was not a closing but an opening.

*Upgrading Kosovo-Montenegro Border Management:* IBM is not just about the free flow of passengers and goods transcending borders, it is also about facilitating efficient regulation of persons and goods entering and leaving the country and having effective counter-measures against all types of illegal cross-border activity across the whole spectrum of trafficking -- i.e. drugs, weapons, ammunition, human beings, money, excisable goods, animals and food products. Each of these illegal activities is a threat to public safety and the economic well-



being of the country. It is essential, therefore, that each agency within their respective countries contributes to the overall intelligence picture that is the foundation from which 'rich picture' risk analysis/assessments and threat assessments are formulated.

Pivotal to achieving the above objectives is the requirement that all three border agencies (Police, Customs, Food and Veterinarian) share responsibility for intelligence gathering and have the capability to provide input on an equal basis. Only by doing so will Intra-service co-operation, Inter-agency co-operation and International co-operation be achieved and be perceived as such.

*Demonstrating State Responsibility:* After long struggle, upon finally attaining its independence, Kosovo assumed the manifold responsibilities of sovereign statehood. In its Declaration of Independence, Kosovo committed to "have its international borders as set forth in Annex VIII of the Ahtisaari Plan, and shall fully respect the sovereignty and territorial integrity of all our neighbors." Now it must follow through on its pledge as it matures as a State. To be sure, the border debate has been contentious. But in 2008 Kosovo did not lose land; it gained a State.

*Improving Public Outreach:* We know from our experience that border disputes can be very emotive. They can involve misunderstandings and even misrepresentations. In the case of Kosovo, its Constitution gives matters of territory a special significance (for example, in Articles 1, 2 and 18 of the Basic Provisions). Thus, in border disputes, we see a heightened need for a transparent process and a well-informed debate.

We found that, unlike standard European practice, the technical preparation of border delineation and the delineation itself were treated as a confidential process. It may have been better to have reached out, to have informed the public more about the process of delineation, as well as about the underlying laws, the cartographic maps and the required geodetic observations. After all, it is today's technical standard that anyone can use a smartphone (with a simple

GPS receiver) to monitor the present position on a digital map with better than 100-meter resolution.

Further, a key publication with the most important results of the State Commission did not reach concerned groups – in particular, the volume entitled “Basic Documents,” a useful compilation of key texts (and included in the Annex). Some salient facts also never reached the public – for example, the fact that there remain, still intact, eighty percent of the border markers used in an earlier exercise to demarcate the Yugoslav line between the SAP Kosovo and the Republic of Montenegro.

*Conforming with International Standards of Registration:* After completion of the entire border exercise, both sides should arrange to provide an additional copy of the border documentation to the United Nations. Such treaties are registered at the UN secretariat (Article 102 of the UN charter), “United Nations Treaty Collection” <http://treaties.un.org/>. According to its own guidelines, INSPIRE is “an EU initiative to establish an infrastructure for spatial information in Europe that is geared to help make spatial or geographical information more accessible and interoperable for a wide range of purposes supporting sustainable development” <http://inspire.ec.europa.eu/>. Finally, we encourage submission of the border coordinates to the European dataset “State Boundaries of Europe” which is part of EuroGeographics <http://www.eurogeographics.org/sbe>.

## **ANNEXES**

Announcement by President Jahjaga on the establishment of the Ad Hoc Commission.

Material submitted by the two State Commissions from Kosovo and Montenegro.

Material submitted by critics of the Border Agreement.

Municipal resolutions pertaining to the Border Agreement and Ad Hoc Commission.

Integrated Border Management Agreements.

Regulation establishing the Kosovo State Commission.